



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

DREJTORIA E ARSIMIT PARASHKOLLOR

SEKTORI I ARSIMIT KULTURËS

1695
Nr. _____ prot.

PROJEKT-VENDIM

Peshkopi, më 19.04.2024

Lënda: MIRATIMI I PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR NË BASHKINË DIBËR

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Dibër

Ne mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsimit Parashkollor dhe Sektori i Arsimit Kulturës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dibër:

KËRKOJMË:

1. Miratimin e "Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Dibër" sipas dokumentacionit bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit Parashkollor.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak dhe i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër.

Drejtori i Arsimit Parashkollor
Alketa DUMANI

Specialiste Arsimi

Alma LLESHI

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr.tel 0355 218 21 66, bashkiadiber@gmail.com

Drejtori Juridik
Ismet SARAÇI

KRYETARI
Rahim SPAHIU
Në mungesë dhe me autorizim

Zv./KRYETARI I BASHKISË
Rruzhdi DEDA



RELACION

PËR MIRATIMIN E "PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR NË BASHKINË DIBER

Në vitin 2015, gjatë periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri, u ndërmorën reforma të rëndësishme që preknin strukturën e Bashkive në vend. Këto ndryshime organizative sollën krijimin e 61 Bashkive të reja, duke sjellë me vete sfida të shumta administrative dhe organizative. Këto transformime u realizuan në përpjekje për të decentralizuar më tej pushtetin lokal dhe për të përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Në lidhje me arsimin parashkollor, Bashkia Diber mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin dhe përmirësimin e këtij sektori në territorin e saj. Pas një eksperience pune tetë vjeçare në ofrimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor, tashmë duke njohur mirë nevojat dhe sfidat Bashkia Diber, ka punuar për një plan të qartë afatmesëm për përmirësimin në vijim të shërbimit për të adresuar nevojat dhe sfidat në kopshte.

Qëllimi i planit është të përmirësojë cilësinë e arsimit parashkollor në Bashkinë Diber, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor. Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin.

Dokumenti gjithashtu përfshin një analizë përmbajtësore e cila përfshin Vizionin, Misionin, dhe Objektivat Strategjike të Planit, duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij. Pjesa e dytë e dokumentit fokusohet në vendosjen e objektivave specifike për secilin proces dhe përcaktimin e treguesve të performancës për t'u përdorur për monitorim. Në pjesën e tretë, paraqitet lista përmbledhëse e aktiviteteve shoqëruar me buxhetin përkatës të mundshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren për rritjen e cilësisë së arsimit parashkollor.

Plani është shtrirë në të gjitha kopshtet nën juridiksionin e Bashkisë Diber dhe do të monitorohet nga Zyra e Arsimit në Bashki, me qëllim përmirësimin e shërbimeve arsimore parashkollore për të gjithë fëmijët në këtë zonë.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Diber përqendrohet në Proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv. Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve në kopshte dhe vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme. Objektivat kryesore të planit përfshijnë rritjen e regjistrimeve dhe frekuentimit në kopshte të vajzave dhe djemve, fuqizimin e strukturave të kopshteve dhe sigurimin e një shpërndarje të barabartë të fëmijëve. Në një periudhë tre vjeçare, Plani prezanton sfidat dhe mundësitë specifike të regjistrimit të fëmijëve, duke përfshirë nevojën për të identifikuar nevojat e komunitetit dhe për të përdorur teknologjinë për të përmirësuar menaxhimin e të dhënave. Lista e aktiviteteve përfshin projekte si punësimi i specialistëve për arsimin parashkollor, vlerësimin e brendshëm kopshteve, themelimin dhe funksionalizimin e organizmave të institucionit arsimor si bordi i kopshtit, këshilli i prindërve, Komisioni i

Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin dhe prindërit për të përmirësuar shërbimin.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit synon të adresojë Proceset Kryesore dhe të përmirësojë shërbimin për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe ata me aftësi të kufizuara në kopshtet publike të Bashkisë Diber. Qëllimi kryesor është të rritet identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi më i mirë i këtyre rasteve në mënyrë që të sigurohet një shërbim cilësor dhe i plotë për fëmijët në nevojë.

Për të arritur këtë qëllim, plani ka disa objektiva të përgjithshëm, si rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimi i procesit të menaxhimit të këtyre rasteve. Në mënyrë specifike, për të adresuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, plani synon të përmirësojë procesin e diagnostikimit të tyre dhe të sigurojë infrastrukturë të përshtatshme në kopshte për t'i bërë ata të aksesueshëm.

Planifikimi dhe zbatimi i Proceseve Mbështetëse në Planin e Përmirësimit të Shërbimit për kopshtet publike të Bashkisë Diber është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët. Këto procese janë themelore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, duke përfshirë trajnimin e stafit, përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve dhe sigurimin e materialeve didaktike. Qëllimi i Proceseve Mbështetëse është të ofrojnë mbështetje efektive për proceset kryesore të shërbimit në kopshte. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë fëmijët.

Për të arritur këtë qëllim, objektivat kryesore përfshijnë plotësimin e standardeve të vendosura nga ligji, për rikonstruksionin e godinave të kopshteve për të përmirësuar infrastrukturën dhe sigurimin e materialeve didaktike për të përmbushur nevojat e zhvillimit të fëmijëve. Për rikonstruksionin e godinave, janë identifikuar nevojat konkrete të kopshteve, duke përfshirë rikonstruksionin e tualeteve, rinovimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, vendosja e rampave atje ku mungojnë si dhe sigurimin e materialeve të nevojshme për këtë qëllim. Në planifikimin e nevojave për materiale, është parashikuar hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar një standard të përshtatshëm për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve në kopshte.

Këto masa synojnë të sigurojnë një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe cilësor për të gjithë fëmijët, vajza e djem, duke përmbushur nevojat e tyre të edukimit dhe zhvillimit në mënyrë efektive.

Zbatimi i Planit do të kërkojë buxhet të nevojshëm për të realizuar të gjitha projektet e përfshira në Planin e Përmirësimit të Shërbimit. Buxheti përfshin fusha të ndryshme, duke përfshirë arsimin bazë dhe arsimin parashkollor, si dhe programe për kujdesin social të familjeve, fëmijëve dhe personave të sëmurë apo me aftësi të kufizuara.

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, paraqesim projekt vendimin për shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në bashkinë Diber.

Drejtoria e Arsimit Parashkollor


Alketa DUMANI




Specialiste Arsimi

Alma LLESHI





**PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR
ARSIMIN PARASHKOLLOR
*BASHKIA DIBËR***



Përmbajtja

1. Hyrje	4
1.1 Qëllimi	5
1.3 Shtrirja	5
1.4 Vizioni	6
1.5 Misioni	6
1.6 Objektivat.....	6
1.7 Përgjegjësitë	6
2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	7
2.1 Qëllimi	7
2.2 Objektiva të përgjithshëm	7
2.3 Regjistrimi i fëmijëve	8
2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht.....	8
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor.....	31
2.4.1 Këshilli i Prindërve	31
2.4.2 Bordi i Kopshtit	38
2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	50
3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	59
3.1 Qëllimi	59
3.2 Objektiva të përgjithshëm	59
3.4 Mbrojtja e fëmijëve	60
3.4.1 Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës	60
3.4.2 Shërbimi bashkiak i mbrojtjes së fëmijës	74
3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar	86
3.5.1 Adresimi i prindërve	86
3.5.2 Kërkesa për fonde shtesë.....	91
3.5.3 Ndihma e përditshme	95
4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit.....	99
4.1 Qëllimi	99
4.2 Objektiva të përgjithshëm	99
4.3 Burimet Njerëzore	100
4.3.1 Rekrutimi i stafit	100

4.3.2 Trajnimi i stafit	105
4.4 Menaxhimi i godinave	115
Rikonstruksioni i objekteve	115
4.5 Materialet	128
4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale	131
4.6 Ushqimi.....	133
4.6.1 Planifikimi i dietës dhe menysë.....	133
5. Buxheti	139

1. Hyrje

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e Arsimit parashkollor. Arsimi, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Dibër. Bashkia Dibër ka nevojë të përmirësojë infrastukturën e kopshteve, për të ofruar shërbim cilësor në Arsimin Parashkollor. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjik.

Gjatë analizimit të të dhënave, vihet re qartë që një nga problematikat kryesore të Bashkisë Dibër, është mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për fëmijët përsa i përket godinave të kopshtit. Mungesa e infrastrukturës sjell shpesh herë probleme të mirëfunksionimit të kopshtit. Gjithashtu, në Bashkinë Dibër ka kërkesa që të shtohet numri i kopshteve me drekë, pasi kopshtet që janë me drekë janë të mbingarkuara.

Bazuar tek proceset e menaxhimit, është e rëndësishme që pranë bashkisë të ngrihet programi i ndërhyrjeve për zhvillimin e infrastrukturës së arsimit i cili ka për qëllim rritjen e cilësisë dhe standardeve të arsimit parashkollor në Bashkinë Dibër duke përmirësuar infrastrukturën fizike arsimore. Një nga sfidat kryesore që has sot arsimi parauniversitar në gjithë vendin është gjendja jo e mirë e infrastrukturës fizike të institucioneve arsimore. Në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, përcaktohet si objektiv i rëndësishëm "rritja e aksesit në arsimin parashkollor, nëpërmjet krijimit të kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe mjediseve shkollore miqësore". Gjithashtu është e rëndësishme që në Bashkinë Dibër të zbatohet rregulli që çdo fëmijë duhet të shkojë në kopshtin që i përket zonës së tij të banimit, duke ofruar shërbim cilësor në çdo kopsht.

Ndërkohë për të rritur numrin e regjistrimeve të fëmijëve në moshë të hershme në kopsht është shumë i rëndësishëm implementimi i konceptit të kopshtit si qendër komunitare. Ky koncept mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, dhe paraqet një qasje gjithëpërfshirëse që ndërlihd të gjithë aspektet e reformës në arsim me vendosjen e fëmijës në qendër të vëmendjes në të gjitha veprimtaritë që organizohen dhe zbatohen në kopsht.

Së dyti, duhet të shihet me prioritet rregullimi i proceseve mbështetëse kryesisht, ai i drejtimit të kopshteve, pasi kopshtet që janë brenda shkollave drejtohen nga drejtori i shkollës. Kopshtet e qytetit varen nga Bashkia, kurse ato të fshatrave varen nga drejtoret e shkollave, pasi ndodhen në brendësi të shkollave e cila është në varësi të ZVAP. Kjo sjell një mungesë totale të koordinimit me bashkinë, pasi pengon realizimin e projekteve për tre vjet për të gjitha kopshtet, siç e thekson edhe Ligji nr. 69 për arsimin. Duhet të shihet me prioritet që për kopshtet brenda shkollës të ketë drejtues, i cili mund të drejtojë 5 kopshte, ashtu siç e përshkruan edhe Udhëzimit nr. 14.

1.1 Qëllimi

Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Dibër dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor. Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

- Përmirësimi i shërbimit në kopshtet ku mungojnë regjistrimet në mënyrë që të rriten regjistrimet;
- Planifikim strategjik përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përsimulësimin e shërbimit në kopshtet që janë brenda shkollave, ose kopshteve që kanë nevojë imediate për restaurim;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimin në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimin;
- Ngritja e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të Arsimit Parashkollor, sipas të cilës të sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata) si edhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të parandaluar dhe eliminuar shkeljet;
- Bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin, për të ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka kopshti në zhvillimin e fëmijës;

Në pjesën e parë të dokumentit gjendet një analizë përmbajtësore e cila do të përmbajë Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjik të Planit, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektiveve të përgjithshëm dhe specifik për secilin proces. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe indikatorët e performancës si dhe objektivat specifik për secilin kriter të përgjithshëm dhe më pas aktivitetet që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e vendosur.

Ndërkohë në pjesën e tretë është përmbledhur buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin parashkollor.

1.3 Shtrirja

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë Dibër. Plani do të implementohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia Dibër. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Drejtoria e Arsimit.

1.4 Vizioni

Përmirësimi i shërbimit të Arsimit Parashkollor, nëpërmjet ngritjes së strukturave për arsimin parashkollor, dhe fuqizimin e tyre për t'ju përgjigjur nevojave të fëmijëve.

1.5 Misioni

Shtimi i ambienteve arsimore për arsimin parashkollor dhe përmirësimi i cilësisë së tyre për të ofruar shërbim cilësor për çdo fëmijë të arsimit Parashkollor.

1.6 Objektivat

- Fuqizimi i Sektorit të Arsimit pranë bashkisë Dibër;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve;
- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe Këshilli i prindërve, Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit;
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për përfshirje sociale.

1.7 Përgjegjësitë

1. Koordinator i planit:
 - Personi përgjegjës për Sektorin e Arsimit, i cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
 - Personi përgjegjës për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale.
2. Aktorët zbatues të planit:
 - Drejtues kopshtit;
 - Mësues i kopshtit;
 - Komuniteti;
 - PMF;
 - Psikologu;
 - GTN;
 - Grupet e terrenit.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
 - Kryetari i Bashkisë;
 - Këshilli i Bashkisë.

2.Procesi i Menaxhimit- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

2.1 Qëllimi

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë.

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimit parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar ulje të numrit të fëmijëve në kopshtet e mbipopulluara; rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, dhe themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

2.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesorë të këtij plani në lidhje me Proceset e Menaxhimit janë:

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit dhe rritja e regjistrimeve përmes ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijës;
2. Krijimi i konceptit të kopshtit si komunitet duke organizuar aktivitete në çdo kopsht ku komuniteti mund të marrë pjesë dhe rritja e angazhimit të komunitetit në përmirësimin e shërbimit të arsimit parashkollor;
3. Themelimi dhe fuqizimi i organizmave si: Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset e menaxhimit të kopshteve.

2.3 Regjistrimi i fëmijëve

2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht

Informacion i përgjithshëm

Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë Dibër për vitin 2023 është **1831**, ndër të cilët **890** janë vajza. Numri i vajzave të regjistruara në kopshtet publike në total rezulton të jetë më i ulët se numri i djemve të regjistruar, pra kemi një diferencë gjinore.

Në bashkinë Dibër, kemi 60 kopshte që funksionojnë brenda shkollave, ndërkohë që kemi marrë në analizë 86 kopshte publike.

Shpërndarja gjeografike e kopshteve është jo lineare. Sipas të dhënave të raportit, numri më i madh i kopshteve publike ndodhet në Njësinë Administrative Maqellarë, Tomin dhe Melan, ndërsa numri më i ulët i kopshteve publike ndodhen në Njësinë Administrative Lurë dhe Zall Dardhë. Shpërndarja e kopshteve publike është bërë sipas zonës gjeografike dhe numrit të popullsisë të përqendruar në çdo Njësi Administrative.

Numri më i lartë i regjistrimeve është në kopshtet e Qytetit e Peshkopisë (546), Maqellarë (270) fëmijë) dhe Tominë (156 fëmijë), ndërsa numri më i ulët i regjistrimeve është në kopshtet e Njësisë Administrative Lurë (11 fëmijë frekuentues) dhe Zall Dardhë (5 fëmijë).

Numri i fëmijëve 3-6 vjeç sipas njësive administrative: (te dhëna nga DSHP-qendrat shëndetësore)

1. Peshkopi	574 femije, 280 vajza/ 294 djem
2. Melan	94 femije, 52 vajza/ 66 djem
3. Slllove	70 femije, 35 vajza/ 35 djem
4. Arras	88 femije, 48 vajza/ 40 djem
5. Kastriot	158 femije 71 vajza/ 78 djem
6. Selishte	42 femije, 20 vajza/ 22 djem
7. Muhurr	61 femije, 25 vajza/36 djem
8. Zall Dardhe	5 femije, 3 vajza/2 djem
9. Zall Rec	10 femije, 4 vajza/ 6 djem
10. Lure	13 femije, 8 vajza/ 5 djem
11. Kala e Dodes	53 femije, 26 vajza/27 djem
12. Fushe Cidhen	92 femije, 48 vajza/ 44 djem
13. Luzni	76 femije, 43 vajza/ 33 djem
14. Maqellare	298 femije, 143 vajza/ 155 djem
15. Tomin	196 femije, 86 femra/110 djem

Objektiva kryesore:

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetur në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit për të siguruar një shërbim efikas.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Unifikimi i të dhënave të arsimit parashkollor mes Bashkisë, ZVAP, NJA dhe kopshteve
2	Ulja e numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në këto grupe
3	Rritja e regjistrimit të fëmijëve në kopshtet në NJA
4	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti në Bashkinë Dibër
5	Rregullimi i procedurës së regjistrimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të akteve formale

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
090	Numri i fëmijëve në Grupin e Përzier	Qender	Vlere	Mesatare	0	0	0	0
090	Numri i fëmijëve në Grupin e Përzier	Periferi	Vlere	Mesatare	290	290	250	250
090	Numri i fëmijëve në Grupin e Përzier	Fshat	Vlere	Mesatare	960	960	950	900

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
089	Numri i fëmijëve në Grupin III	Qender	Vlere	Mesatare	208	210	210	210
089	Numri i fëmijëve në Grupin III	Periferi	Vlere	Mesatare	105	105	105	105
089	Numri i fëmijëve në Grupin III	Fshat	Vlere	Mesatare	350	350	350	350
088	Numri i fëmijëve në Grupin II	Qender	Vlere	Mesatare	151	150	150	150
088	Numri i fëmijëve në Grupin II	Periferi	Vlere	Mesatare	100	100	105	105
088	Numri i fëmijëve në Grupin II	Fshat	Vlere	Mesatare	317	325	340	350
087	Numri i fëmijëve në Grupin I	Qender	Vlere	Mesatare	186	186	185	180
087	Numri i fëmijëve në Grupin I	Periferi	Vlere	Mesatare	85	85	85	85
087	Numri i fëmijëve në Grupin I	Fshat	Vlere	Mesatare	300	315	317	317
010	Numri i punonjësve në Njësinë që menaxhon arsimin	Bashki	Vlere	Shumatore	1	1	1	1

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	parashkollor brenda Bashkisë							
009	Instrumenta teknologjike për dixhitalizimin dhe menaxhimin e të dhënave	Bashki	Vlere	Shumatore	0	0	1	1
003	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku ka marrë pjesë komuniteti	Qender	Vlere	Mesatare	2	2	3	4
003	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku ka marrë pjesë komuniteti	Periferi	Vlere	Mesatare	1	1	2	3
003	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku ka marrë pjesë komuniteti	Fshat	Vlere	Mesatare	1	1	2	3
008	Numri i fëmijëve në grup-moshën 3-5 vjeç	Qender	Vlere	Shumatore	574	540	540	540
008	Numri i fëmijëve në grup-moshën 3-5 vjeç	Periferi	Vlere	Shumatore	290	290	290	290
008	Numri i fëmijëve në	Fshat	Vlere	Shumatore	967	960	960	960

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	grup-moshën 3-5 vjeç							
002	Norma e regjistrimit në kopsht	Qytet	%	Tjeter	95	95	96	97
002	Norma e regjistrimit në kopsht	Periferi	%	Tjeter	85	87	88	90
002	Norma e regjistrimit në kopsht	Fshat	%	Tjeter	70	72	75	75
001	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht	Qender	Vlere	Shumatore	574	540	540	540
001	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht	Periferi	Vlere	Shumatore	290	290	290	290
001	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht	Fshat	Vlere	Shumatore	967	960	960	

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
005	Vlerësimi i Brendshëm i kopshteve	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
004	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht	Drejtorja e Arsimit		0	0	0	0
003	Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Drejtorja e Arsimit	0	0	0	860000	0
002	Regjistrimi në kopsht sipas vendbanimit	Drejtorja e Arsimit		0	0	0	0
001	Krijimi i platformës digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin	Drejtorja e Arsimit	0	0	0	0	0

Listae projekteve

Nr. 001	Projekti: Krijimi i platformës digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Gjatë punës për diagnostikimin dhe përgatitjen e raporteve analitike të situatës të Arsimit Parashkollor në Bashkinë Dibër u vu re një mosrakordim i të dhënave mes Bashkisë, Njësi Administrative dhe kopshteve.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Mosrakordimi i të dhënave mes Bashkisë, Njësi Administrative dhe kopshteve u vu re në të dhëna si numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte, numri i mësuesve, numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale (me disavantazh social), kapaciteti akomodues i kopshteve, etj.		

Mosrakordimi i të dhënave vështirëson diagnostikimin e situatës, evidentimin e problemeve dhe shkaqeve të tyre dhe evidentimin e nevojës për ndërhyrje ose ndryshime në kopshte.

Duke mos pasur një databazë të unifikuar të të dhënave mes këtyre dy institucioneve, nuk është e qartë nëse duhet të mbyllet disa kopshte meqë janë nën kapacitet dhe fëmijët të transferohen në kopshte të tjera të afërta, apo të ndërtohen kopshte të reja për të ulur mbipopullimin. Problematika reale është e vështirë të identifikohet menjëherë dhe si pasojë edhe zgjidhjet për të do të vonohen të zbatohen.

Është e nevojshme të krijohet një sistem i unifikuar i të dhënave në kohë reale, në mënyrë që të dhënat të jenë të sakta, të gjithë aktorët të kenë akses te këto të dhëna dhe ndryshimi i tyre të jetë i menjëhershëm, pa kosto dhe njëkohësisht të të gjitha databazat e aktorëve. Në këtë mënyrë, Drejtoria e Arsimit pranë Bashkisë dhe ZVAP do të mund të bëjnë parashikimet dhe planifikimet e nevojshme për ofrimin e një shërbimi efikas.

ii Synimi i projektit

Një mënyrë për të pasur një unifikim të të dhënave në kohë reale është krijimi i një Platforme Digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin.

Në këtë platformë mund të kenë akses:

- Drejtoria e Arsimit mund të ketë akses te të gjitha të dhënat për çdo kopsht dhe është përgjegjëse për plotësimin e tyre.
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territori mund të ketë akses në seksionin e gjendjes fizike të ndërtesave të kopshteve, për të plotësuar të dhënat për çdo kopsht, pas vlerësimit të kryer çdo vit.
- Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit për të plotësuar të dhënat për fëmijët në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar.

Nëpërmjet këtij projekti synohet rakordimi i të dhënave dhe koordinimi mes Bashkisë, Njësive Administrative, ZVAP dhe kopshteve dhe lehtësimi i procesit të vlerësimit të nevojave që ka çdo kopsht. Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur që situata e arsimit parashkollor të jetë e qartë. Ky projekt sigurisht do të realizohet edhe me mbështetjen e vazhdueshme të stafit IT të Bashkisë.

Struktura e Platformës do të përmbajë:

1. **Seksionin e të dhënave të përgjithshme** (emri i kopshtit, njësia administrative, adresa, nëse kopshti është publik ose privat, me ushqim ose pa ushqim, në godinë më vete ose jo, emri dhe kontaktet e drejtuesit, etj.)

2. **Seksioni i të dhënave të fëmijëve** (numri i fëmijëve të regjistruar sipas moshës, gjinisë dhe grupit ku bëjnë pjesë, numri i grupeve sipas llojeve, numri i fëmijëve në çdo grup, frekuentimi çdo muaj, etj.)
3. **Seksioni i të dhënave mbi organizmat që funksionojnë brenda kopshtit** (Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit).
4. **Seksioni i të dhënave të inventarit të kopshtit** (numri i mobilieve, viti i blerjes, gjendja e tyre, materialet didaktike dhe kancelarike, etj.)
5. **Seksioni i Shërbimeve Sociale** (numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale dhe aftësi të kufizuar sipas vendbanimit/kopshtit, moshës, gjinisë, etj.)
6. **Seksioni i gjendjes fizike të godinës së kopshtit** (nevojat për mirëmbajtje dhe rikonstruksion sipas prioritetit të ndërhyrjes, furnizimi me ujë, elektricitet, internet dhe ngrohje, numri i hapësirave, sipërfaqja e secilës prej hapësirave, etj.)
7. **Seksioni i Burimeve Njerëzore** (numri i mësueseve, mësueseve ndihmëse, stafit mbështetës, përvoja në punë, mosha dhe gjinia, etj.)

Nëpërmjet platformës mund të gjenerohen edhe analizat e situatës nga të dhënat e plotësuar. Për shembull, mund të llogaritet kapaciteti akomodues i kopshteve (duke marrë si referencë hapësirat në m² të kopshteve, numrin e klasave, etj.). Gjithashtu, mund të llogaritet numri i fëmijëve për një mësuese, norma e frekuentimit, norma e regjistrimit të fëmijëve, numri i karrigeve për 1 tavolinë, numri i shtretërve, numri i fëmijëve që flenë në kopsht dhe kërkesa për mobilje të reja në secilin prej kopshteve. Kështu, Drejtoria e Arsimit do të ketë të qartë situatën e kopshteve dhe nevojës për ndërhyrje.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Hartimi i një rregullore për mënyrën e plotësimit të Platformës Digjitale, institucionet që kanë akses, afatet e plotësimit ose të dërgimit të të dhënave te Drejtoria e Arsimit;
2. Hartimi i një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe ZVAP mbi raportimin e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte për të shmangur raportimin direkt të kopshteve pranë ZVAP dhe si rrjedhim mosrakovordin e shifrave.

B: Menaxheriale

1. Përgatitja e Platformës Digjitale për hedhjen e të dhënave individuale të kopshteve dhe gjenerimin e analizave. **mund të krijohet dhe hostohet nëpërmjet specialisteve të IT në bashki.**
2. Dërgimi i informacioneve të detajuara drejt Drejtorisë së Arsimit nga kopshtet sipas procedurave të përcaktuara në rregullore.
3. Plotësimi i të dhënave nga Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

<ol style="list-style-type: none"> 4. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit kryen vlerësimin e ndërtesave të kopshteve çdo vit nëpërmjet vizitave në terren. Vlerësimi fillon në muajin Mars të çdo viti dhe përfundon në muajin Prill. Të dhënat e mbledhura nga inspektimet hidhen në Platformën Digjitale brenda muajit Maj. 5. Gjenerimi i analizave të situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjes në nivel kopshti nga Drejtoria e Arsimit; 6. Dërgimi i të dhënave të ZVAP dhe Njësitë Administrative. 	
<p>iv Aktivitetet kryesore të projektit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. mirëmbajtja e Platformës Digjitalen ose krijimi i saj nga stafi I bashkise 2. Trajnimi i punonjësve që do të hedhin të dhëna ose do të gjenerojnë analiza nga stafi i Bashkisë. Pas blerjes së platformës, do të trajnohet stafi i cili do të jetë përgjegjës për përdorimin e Platformës. 3. Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave. Stafi i kopshteve, Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Strehimit njihet me rregulloren. 	
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Platforma Digjitale me të dhënat individuale të kopshteve të plotësuara në kohë reale 2. Analiza e Situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjeve 3. Zgjidhja e problemeve në kohë reale 	
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Arsimit • Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit • Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit • Drejtoria e IT • Njësia e Prokurimit 	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kopshtet • ZVAP • NJA • Operatori ekonomik
<p>e) Shpenzimet e llogaritura(për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p>	

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Blerja dhe mirëmbajtja e Platformës Digjitale	Drejtoria e Arsimit/Njësia e Prokurimit		0	0	0	0
2	Trajnimi i punonjësve që do të hedhin të dhëna ose do të gjenerojnë analiza	Operatori ekonomik		0	0	0	0
3	Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2025			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit				

Nr. 002	Projekti: Regjistrimi në kopsht sipas vendbanimit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		

Regjistrimi i fëmijëve bëhet sipas hartës së vendbanimit por ka dhe raste specifike kur kjo nuk ndodh. Kryesisht kopshtet mbyllin regjistrimet e tyre me fëmijët e zonës dhe nëse kanë hapsira boshe mund të regjistrojnë edhe fëmijë nga jashtë zonës së vendbanimit, kjo për arsye të ndryshme që mund të lidhen me punësimin e prindërve afër këtyre kopshteve etj. Prioritet i jepet fëmijëve në ndihmë, ku bashkia në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve sociale për këto raste specifike, ju jep mundësinë prindërve të zgjedhin ti regjistrojnë fëmijët e tyre pranë kopshteve ku ata punojnë ose pranë shtëpive të gjyshërve.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Shpërndarja jo e barabartë e fëmijëve në kopshte shkakton mbipopullim të disa kopshteve dhe nënpopullim të kopshteve të tjera. Mbipopullimi i kopshteve shkakton pengesa në procesin e edukimit dhe menaxhimit të fëmijëve, ndërsa nënpopullimi bën që hapësirat, në të cilat është investuar dhe janë në gjendje shumë të mirë, të mos shfrytëzohen maksimalisht.

ii Synimi i projektit

Për të siguruar shpërndarjen e barabartë të fëmijëve në kopshte është e rëndësishme të sigurohet që cilësia e shërbimit të të gjithë kopshtet është e njëjtë dhe regjistrimi kryhet sipas zonës së banimit dhe jo preferencave të prindërve. Ky projekt përqendrohet në realizimin e regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit nëpërmjet përcaktimit të një rregulloreje, e cila do të ndiqet nga të gjitha kopshtet.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Urdhër nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin e fëmijëve në kopshtet pranë zonës së tyre të banimit;
2. Hartimi i një rregulloreje që përcakton procedurën, aktorët përgjegjës, afatet kohore dhe mënyrën e ndërveprimit ndërmjet palëve gjatë procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopshte nga Drejtoria e Arsimit.

B: Menaxheriale

Një model i rregullores mund të jetë si më poshtë:

1. Prindërit përpos dokumentave që dorëzojnë për regjistrimin e fëmijëve në kopsht, duhet të dorëzojnë dhe Certifikatën e vendbanimit. Afati i dorëzimit të dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve është 1 - 10 qershor;
2. Kopshti merr dokumentet e dorëzuara nga prindërit për çdo fëmijë dhe ia dërgon Drejtorisë së Arsimit. Dokumentet për çdo fëmijë mund të dërgohen nga kopshti deri në 2 ditë pas mbylljes së afatit të aplikimit;
3. Drejtoria e Arsimit merr vendimin bazuar në dokumentet e secilit prej fëmijëve dhe listën që disponon me fëmijët në moshë kopshti dhe i dërgon kopshteve listën e fëmijëve të regjistruar dhe listën e fëmijëve që nuk u është pranuar aplikimi së bashku me arsyet. Afati për marrjen e vendimit është deri në fund të qershorit. Gjithashtu, identifikon

<p>nëpërmjet listës së fëmijëve në moshë kopshti, fëmijët që nuk janë regjistruar ende në kopsht;</p> <ol style="list-style-type: none"> Në rastin kur një aplikim për regjistrim refuzohet, prindërit njoftohen nga drejtuesi i kopshtit mbi arsyet pse është refuzuar aplikimi dhe i sugjeron kopshtin në të cilin fëmijës i takon të regjistrohet; Hartimi i një kontrate tip mes prindërve dhe kopshteve për të përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e secilës palë; Pasi regjistrimet përfundojnë, sipas udhëzimeve të Drejtorisë së Arsimit, drejtuesit/mësuesit e kopshteve mund të takojnë prindërit të cilët nuk kanë regjistruar ende fëmijët, për të identifikuar arsyet e mos regjistrimit dhe informuar prindërit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor të fëmija. Kjo detyrë mund t'i përcaktohet dhe një punonjësi tjetër, si përshebull grupeve të terrenit që kanë si detyrë identifikimin e fëmijëve në situatë rruge. 	
<p>iv Aktivitetet kryesore të projektit</p> <ol style="list-style-type: none"> Nxjerrja e Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin sipas zonës së banimit; Hartimi i rregullores mbi procedurën e regjistrimit; Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit; Hartimi i një kontrate tip mes prindërve dhe kopshteve; Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht; Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve. 	
<p>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)</p> <ol style="list-style-type: none"> Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit; Shpërndarje e njejtë e regjistrimit të fëmijëve; Rritje e numrit të regjistrimeve; Ulje e numrit të grupeve të përziera dhe/ose numrit të fëmijëve në këto grupe. Me urdhër të Kryetarit të pranohen vetëm raste të veçanta të regjistrimit të fëmijëve sipas një procedure të caktuar, në kopshte të cilat ndodhen jashtë zonës së vendbanimit. 	
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> Drejtorja e Arsimit Kryetari i Bashkisë 	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> Prindërit/Persona me përgjegjësi prindërore Drejtues/mësues të kopshteve Grupet e Terrenit
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p>	

N r	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktua l	Buxhe ti Viti 2024	Buxhe ti Viti 2025	Buxhe ti Viti 2026	Tota l
1	Nxjerrja e Urdhrit për regjistrimin sipas zonës së banimit	Kryetari i Bashkisë		0	0	0	0
2	Hartimi i rregullores mbi procedurën e regjistrimit	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
3	Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
4	Hartimi i një kontrate tip mes prindërve dhe kopshteve	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
5	Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0

6	Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve	Drejtoria e Arsimit/drejtues/mësues/Grupet e Terrenit		0	0	0	0
				0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit				

Nr. 003	Projekti: Organizimi i aktiviteteve të përbashkta mes komunitetit dhe kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje ose aktivitete që lidhen me Arsimin Parashkollor është e ulët në Njësitë Administrative. Në Njësitë Administrative numri i fëmijëve të regjistruar është i ulët. Ky fakt mund të vijë si pasojë e infrastrukturës së kopshteve dhe/ose mentalitetit të prindërve mbi arsimin parashkollor si një faktor jo i rëndësishëm në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Mospërfshirja e komunitetit në aktivitete ose çështje të rëndësishme të arsimit parashkollor është një tregues i mungesës së interesit të komunitetit për këto çështje, duke i konsideruar si çështje të një rëndësie jo shumë të madhe. Ky mentalitet mund të jetë një arsye e numrit të ulët të regjistrimit të fëmijëve në kopsht në Njësitë Administrative. Gjithashtu, nëse arsimi parashkollor nuk konsiderohet si prioritet nga komuniteti, atëherë mund të ndodhë të mos jetë një prioritet për vetë Bashkinë.</p> <p>Për shkak të numrit të vogël të fëmijëve të regjistruar në kopshtet e Njërive Administrative, formohen grupet e përziera. Aktualisht, numri i grupeve të përziera është më i lartë se numri i grupeve të I, II dhe III dhe numri i fëmijëve në këto grupe është i lartë. Ky fakt shkakton vështirësi në edukimin dhe menaxhimin e fëmijëve.</p>		

Gjithashtu, për shkak të çështjeve dhe problemeve më madhore të Bashkisë dhe fokusit të saj te Programe Strategjike të Buxhetit, problemet e kopshteve gjatë hartimit të buxhetit mund të mos adresohen ashtu siç duhet dhe për pasojë buxheti i vendosur për arsimin parashkollor mund të mos jetë i mjaftueshëm për zgjidhjen e problemeve si rikonstruksioni i kopshteve apo ndërtimi i kopshteve të reja.

ii Synimi i projektit

Një mënyrë për të zgjidhur këtë çështje është përfshirja e komunitetit në aktivitete të organizuara nga kopshtet. Në këtë mënyrë, pritet të rritet ndërgjegjësimi i komunitetit (përfshirë prindërit) për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijëve dhe si pasojë pritet të rritet pjesëmarrja aktive në vendimmarrje, lobimi dhe theksimi i çështjeve që kanë nevojë të theksohen përsa i përket arsimit parashkollor.

Nëpërmjet aktiviteteve të iniciuara nga Drejtoria e Arsimit dhe vënia në zbatim nga drejtuesit dhe mësuesit e kopshteve, synohet:

1. **Zhvillimi i fëmijëve.** Në këto aktivitete, protagonistët kryesorë do të jenë fëmijët, duke recituar, treguar përralla, kërcyer, etj. Në këtë mënyrë, aftësitë e fëmijëve për të bashkëpunuar dhe mësuar gjëra të reja do të rriten;
2. **Informimi i komunitetit.** Këto aktivitete është mirë që të ndërthuren dhe me sesione të shkurtra informuese për rëndësinë që ka arsimit parashkollor te formimi i fëmijëve ose të jenë kryesisht me natyrë informuese. Përveç aktivizimit të fëmijëve, komuniteti do të njihet, nëpërmjet mësueseve, edhe me faktin se sa i rëndësishëm është arsimit dhe nevojën që ekziston që ky komunitet të jetë më aktiv në çështje të arsimit parashkollor. Në këtë mënyrë, mund të lobohet prej tyre gjatë hartimit të buxhetit në Bashki për të rritur buxhetin e vendosur për kopshtet;
3. **Rritja e regjistrimeve.** Shumë prindër, duke e konsideruar kopshtin si një nivel jo të rëndësishëm të arsimit nuk i regjistrojnë ata në kopsht. Arsye të tjera të mos regjistrimit mund të jetë mos njohja e ambienteve të kopshteve, mësueset dhe stafin e kopshteve. Nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga kopshti, ata do të njihen me ambientet, mësueset, mënyrat e mësimdhënies, përfitimet e fëmijës nga kopshti dhe në këtë mënyrë synohet të rritet norma e regjistrimit;
4. **Ulja e grupeve të përziara dhe e numrit të fëmijëve në grupet e përziara.** Me rritjen e regjistrimit mund të ulët dhe numri i fëmijëve në grupet e përziara. Duke qenë se ato formohen kur numri i fëmijëve për të formuar grup të I, II dhe III nuk është i mjaftueshëm, rritja e normës së regjistrimit do të mundësojë zvogëlimin e numrit të grupeve të përziara dhe numrin e fëmijëve në këto grupe.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Kopshtet në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve planifikon aktivitetet. Për të rritur sa më shumë partneritetin si me komunitetin por edhe motivimin e Këshillit të Prindërve për të qenë aktorë të rëndësishëm në zhvillimin e kopshtit, duhet që Bashkia të njohë disa pika kyçe të zonës ku është kopshti si p.sh.
 1. *Cilat janë karakteristikat kyçe dhe pikat e forta të komunitetit ku ndodhet kopshti*
 2. *Çfarë mund të bëni ju dhe çfarë mbështetje kërkon ju për të mbështetur kopshtin në fusha të tilla si disiplinimi pozitiv, ndërgjegjësimi për rëndësinë e edukimit në moshë të hershme*
 3. *A ka partneritete të ndërtuara mes kopshtit dhe kulturave të ndryshme të komunitetit*
2. Kalendarit i aktiviteteve i dërgohet Drejtorisë së Arsimit;
3. Organizohen takime me komunitetin për krijimin e Grupit të Vullnetarëve.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

Shtator	Tetor-Dhjetor	Janar-Mars (vetëm për kopshtet e NJA)	Prill-Gusht (vetëm për kopshtet e NJA)
Prindërit dhe mësuesit takohen për të diskutuar: 1. Aktivitetet që do realizohen gjatë vitit; 2. Nevojat që kanë fëmijët dhe komuniteti; 3. Kopshti rrit informimin mbi rolin dhe përgjegjësinë e Këshillit të Prindërve.	Kopshti: -Planifikon aktivitetet bazuar te nevojat e fëmijëve dhe komunitetit. Prindërit: -Marrin pjesë tek aktivitetet që ata kanë shprehur dëshirën të jenë pjesëmarrës; -Informohen nga kopshti në mënyrë të vazhdueshme për planin që zhvillon kopshti.	Në bashkëpunim me kopshtin dhe bashkinë, organizohen takime me komunitetin për të krijuar grupin e vullnetarëve (prindër, studentë, dhe pjestarë të tjerë të komunitetit). Grupi i vullnetarëve merr pjesë në organizimin e aktiviteteve të ardhshme.	-Kopshti ofron aktivitete në ambient të hapur; -Komuniteti mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete; -Prindërit ndihmojnë fëmijën në ndjekjen e detyrave.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht;

<p>2. Angazhim më i madh i Këshillit të Prindërve në kopsht;</p> <p>3. Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor dhe nevojën për të pasur më shumë përfshirje nga ana e tyre.</p>							
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Arsimit 				<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> Komuniteti Kopshti Gjimmazet 			
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p>							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Përgatitja e kalendarit të aktiviteteve	Drejtuesi i kopshtit	0	0	0	0	0
2	Takim me Këshillin e Prindërve	Drejtuesi i kopshtit	0	0	0	0	0
3	Shqyrtimi me Bordin e Kopshtit	Drejtuesi i kopshtit	0	0	0	0	0
4	Realizimi i aktiviteteve (buxheti = 10 mijë lek/kopsht)	Drejtuesi i kopshtit		0	860000	0	860000
			0	0	860000	0	860000
<p>f) Periudha e zbatimit: 2024-2025</p>				<p>g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit</p>			

Nr. 004	Projekti: Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht.	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
---------	--	--

a) Përshkrim i shkurtër i projektit**i Situata**

Kopshtet në Bashkinë Dibër nuk hartojnë dhe zbatojnë një plan afatmesëm.

Plani Afatmesëm përmban:

- Misionin;
- Vizionin;
- Analiza e gjendjes;
- Përparësitë;
- Veprimtaritë kryesore për realizimin e përparësive;
- Produkti ose treguesit e arritjeve;
- Buxheti i përafërt.

Duke mos hartuar një plan afatmesëm, kopshtet nuk kanë një analizë të qartë të situatës, objektiva dhe një plan aktiviteteve për të arritur objektivat.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Në Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 *“Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”* përcaktohet kompetenca e hartimit të Planit Afatmesëm të IA dhe rubrikat e tij. Sipas tij, detyrën për ngritjen e grupit të punës nga mësues dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore (me kryetar drejtuesin e kopshtit) për hartimin e planit afatmesëm e ka drejtuesi i kopshtit.

ii Synimi i projektit

Nëpërmjet këtij projekti synohet rritja e kapaciteteve në lidhje me hartimin e planit afatmesëm dhe hartimi i planit në gjithë kopshtet e Bashkisë Dibër.

iii Niveli i ndërhyrjes**A: Ligjore**

1. Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ku përcakton se kompetencat për monitorimin e hartimit dhe zbatimit të planit afatmesëm e ka Drejtoria e Arsimit dhe drejtuesit e kopshteve duhet të raportojnë te ZVAP dhe Bashkia.

B: Menaxheriale

1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për hartimin e planit afatmesëm;
2. Zbatimi i Urdhrit nr. 31, neni 49 dhe 50 për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm në të gjitha kopshtet e Bashkisë Dibër.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

<ol style="list-style-type: none"> Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm. Kostot për një person janë 1.5 mijë lekë. Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo kopsht. 							
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme) <ol style="list-style-type: none"> Kopshtet vendosin vetë objektiva dhe arrijnë ato; Kopshtet funksionojnë jo vetëm si institucione në varësi të Bashkisë, por kanë edhe plane dhe objektiva të vetat që nxisin zhvillimin më të shpejtë të tyre. 							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Arsimit 				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) <ul style="list-style-type: none"> Kopshtet ZVAP 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm	Drejtoria e Arsimit		0	0	6000	6000
2	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo kopsht	Drejtuesit e kopshteve		0	0	0	0
				0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2025				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit			

Nr. 005	Projekti: Vlerësimi i Brendshëm i kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
---------	--	--

a)Përshkrim i shkurtër i projektit**i Situata**

Aktualisht, nuk ekziston një metodë e unifikuar për vlerësimin e brendshëm të kopshteve. Vlerësimi i brendshëm ka si synim të analizojë pikat e forta, mundësitë për përmirësime dhe faktorët që kanë favorizuar ose penguar cilësinë. Vetëvlerësimi, në asnjë rrethanë, nuk duhet të bëhet qëllim në vetvete. Ai bëhet shumë më i fuqishëm, kur rezultatet transformohen në një plan zhvillimi. Plani duhet të identifikojë fusha dhe probleme që kërkojnë ndryshim dhe zgjidhje të reja, gjithashtu, duhet të identifikojë edhe objektivat, procedurat, burimet njerëzore dhe financiare për procesin e ndryshimit.

Vetëvlerësimi ka qëllim matës, kur plani i veprimit ka qëllim përmirësimin e cilësisë. Transparenca e proceseve dhe rezultateve siguron automatikisht strategji komunikimi, nëpërmjet një publikimi aktiv.

Qëllimi i metodologjisë së vlerësimit të brendshëm është të drejtojë, të orientojë, të lehtësojë mësuesit, organizmat kolegjalë të kopshtit, drejtuesit e kopshtit, për të vlerësuar veten, me qëllim ndërgjegjësimin e të gjithëve aktorëve të kopshtit, sepse ata janë forca më e qenësishme, më e qëndrueshme e ndryshimit për përmirësimin e kopshtit.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 *“Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”*, vlerësimi i brendshëm:

1. përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të institucionit, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin;
2. kryhet çdo vit;
3. mbulon të gjitha fushat që përfshin monitorimi dhe vlerësimi i IA-së;
4. vlerësimi i brendshëm kryhet në nivel individual (drejtori, mësuesi, psikologu) dhe në nivel organizmash.

ii Synimi i projektit

Vlerësimi i brendshëm i kopshteve ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga ana e tij, nëpërmjet analizës dhe reflektimit për arritjet dhe mundësitë për përmirësime. Ky projekt ka si synim hartimin e një metode të unifikuar për të gjithë kopshtet për të kryer çdo vit vlerësimin e brendshëm. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të përcaktohen fushat mbi të cilat realizohet vlerësimi i brendshëm. Përvoja ka treguar që duhet që vlerësimi i brendshëm të ketë të njëjtat fusha mbi të cilat realizohet vlerësimi i jashtëm i kopshtit.

iii Niveli i ndërhyrjes**A: Ligjore**

1. Nxjerrja e një udhëzuesi metodologjik për vlerësimin e brendshëm të kopshtit. ASCAP ka hartuar tashmë udhëzuesin metodologjik për vlerësimin e brendshëm të shkollës.
2. Nxjerrja e Urdhrit nga Kryetari i Bashkisë, për realizimin e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshtit.

B: Menaxheriale

1. Bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Brendshëm (Urdhër nr. 54, datë 26.05.2020 “Për miratimin e paketës së vlerësimit të cilësisë së shkollës”) ASCAP harton pyetësorë për mësuesit, prindërit dhe drejtorët e kopshteve/përgjegjësit e kopshteve për të kryer vlerësimin e brendshëm;
2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve për vlerësimin e brendshëm bazuar mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Brendshëm të Shkollës/Kopshtit nga ASCAP;
3. Drejtuesit e kopshteve trajnojnë stafin arsimor të kopshtit dhe organizmat e kopshtit (Këshillin, Bordin dhe Komisionin) për kryerjen e vlerësimit të brendshëm;
4. Drejtuesi i kopshtit organizon një fokus grup me personat me përgjegjësi prindërore, mësuesit dhe anëtarë të tjerë të organizmave të kopshtit për të diskutuar për një numër të vogël temash ose aspektesh që lidhen me kopshtin. Fokus grupi zhvillohet në periudhën kohore të pranuar nga të gjithë anëtarët dhe ka 6-8 pjesëmarrës;
5. Koordinator i grupit, me ndihmën e koordinatorit të ZVAP, harton analizën përmbledhëse të vlerësimit të brendshëm.
6. Rezultatet mund të përdoren për hartimin e planit afatmesëm të kopshteve ose planeve vjetore.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve nga ASCAP;
2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga ASCAP;
3. Trajnimi i stafit arsimor të kopshteve dhe organizmave të kopshtit mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshteve;
4. Organizimi i fokus grupeve;
5. Analiza dhe raportimi i rezultateve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Kryerja çdo vit e vlerësimit të brendshëm të kopshteve sipas udhëzimit të posaçëm të MASR;
2. Nxitja për vet-përmirësim i mësuesve, drejtuesve dhe organizmave të kopshteve;
3. Planifikimi më objektiv bazuar në rezultatet e vlerësimit të brendshëm.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Arsimit 				<ul style="list-style-type: none"> ZVAP ASCAP 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve	ASCAP		0	0	0	0
2	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm	ASCAP		0	0	0	0
3	Trajnimi i stafit arsimor të kopshteve dhe organizmave të kopshtit mbi metodën e vlerësimit të brendshëm	Drejtuesit e kopshteve		0	0	0	0
4	Organizimi i fokus grupeve	Drejtuesit e kopshteve		0	0	0	0
5	Analiza dhe raportimi i rezultateve	Koordinator i Grupit dhe ZVAP		0	0	0	0
					0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit			

Risqet

Risku	Mitigimi
Regjistrimi fëmijëve sipas zonës së banimit mund të detyrojë prindërit të regjistrojnë fëmijët në kopshte që nuk janë	Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë që fëmija e tyre të regjistrohet pranë zonës së tyre reale të banimit, nëse mund ta vërtetojnë në mënyrë

Risku	Mitigimi
pranë zonës ku ata banojnë realisht, por në kopshte ku kanë zonën e banimit zyrtarisht.	zyrtare nëpërmjet një kontrate qiraje, kontrate pune, hipoteka e shtëpisë, etj.

2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

2.4.1 Këshilli i Prindërve

Informacion i përgjithshëm

Nga analiza e situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Dibër rezulton se 10 kopshte nga 86 nuk kanë dhënë asnjë informacion nëse e kanë themeluar Këshillin e Prindërve.

Sipas analizës së të dhënave, vihet re se, numri minimal i anëtarëve të këshillit të prindërve është 1, numri mesatar është 3, ndërsa numri maksimal është 5.

Numri minimal prej 1 anëtarësh është raportuar në Njësinë Administrative Kastriot.

Numri i anëtarëve të Këshillit të Prindërve, që i përkasin gjinisë “femër” është më i lartë, në krahasim me numrin e anëtarëve të gjinisë “mashkull”, në të gjitha Njësitë Administrative.

Objektiva kryesore:

Fuqizimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tij.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve në të gjithë Kopshtet.
2	Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve në menaxhimin e kopshtit

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
017	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga	Qender	Vlere	Mesatare	2	3	4	5

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	Këshilli i Prindërve							
017	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Këshilli i Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare	1	2	2	3
017	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Këshilli i Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare	0	1	1	2
016	Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve	Qender	Vlere	Mesatare	2	3	3	4
016	Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare	1	2	3	4
016	Numri i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare	1	1	2	3
015	Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim	Qender	Vlere	Mesatare	2	2	3	4

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	me Këshillin e Prindërve							
015	Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare	0	1	1	2
015	Numri i aktiviteteve të kopshtit të organizuara në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare	0	1	1	2
014	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë	Qender	Vlere	Mesatare	2	3	3	4
014	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë	Periferi	Vlere	Mesatare	1	1	1	2
014	Numri i aktiviteteve të kopshtit ku Këshilli i Prindërve ka marrë pjesë	Fshat	Vlere	Mesatare	0	1	2	3

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
013	Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve	Qender	Vlere	Mesatare	5	5	6	7
013	Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare	3	3	4	5
013	Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare	2	3	3	4
012	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Qender	Vlere	Mesatare	0	0	1	1
012	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Periferi	Vlere	Mesatare	0	0	1	1
012	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Fshat	Vlere	Mesatare	0	0	1	1
011	Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve	Qender	Vlere	Shumatore	2	2	2	2

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
011	Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve	Periferi	Vlere	Shumatore	10	12	14	15
011	Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve	Fshat	Vlere	Shumatore	60	60	65	65

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
006	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Drejtoria e Arsimit	0	0	13.5 mijë lekë	0	0

Listae projekteve

Nr. 006	Projekti: Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Sipas 90/pika 1: Këshilli i prindërve mbledhet të paktën tre herë në vit. Mbledhje të tjera zhvillohen me nismen e kryetarit të këshillit të prindërve ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij.</p>		

Në Bashkinë Dibër rezulton se 10 kopshte nga 86 nuk kanë dhënë asnjë informacion nëse e kanë themeluar Këshillin e Prindërve. Për kopshtet të cilat ndodhen brenda ambientit të shkollave, organizmat e ngritura për shkollën funksionojnë edhe për kopshtet.

Sipas raportimeve, vihet re se numri minimal i anëtarëve të këshillit të prindërve është 1, numri mesatar është 3, ndërsa numri maksimal është 5.

Numri minimal prej 1 anëtarësh është raportuar në Njësinë Administrative Kastriot. Numri i anëtarëve të Këshillit të Prindërve, që i përkasin gjinisë “femër” është më i lartë, në krahasim me numrin e anëtarëve të gjinisë “mashkull”, në të gjitha Njësitë Administrative. Ndërkohë mungon në të dhënat tona % e numrit të prindërve që marrin pjesë në takime, për të kuptuar sa e rëndësishme është mbledhja e këtij Këshilli për të sjellë ndryshime në kopësht.

Gjithashtu vihet re që temat që diskutohen shpeshpër lidhen edhe me përgjegjësi të cilat nuk i zgjidh dot as këshilli dhe as vetëm kopshti, ndaj është shumë e rëndësishme që bashkia, të jetë në dijeni të problematikave që ngrihen nga prindërit.

Temat që diskuton këshilli prindërve

- Mënyra se si fëmijët duhet ta kalojnë kohën e lirë
- Bashkëpunimi prind-edukator-fëmijë
- Integrimi i fëmijeve në kopësht dhe marrja e nismave gjithëpërfshirëse në dobi të tyre
- Frekuentimi i fëmijeve në kopësht dhe vijueshmëria e tyre në grup
- Mënyra se si fëmijët duhet ta kalojnë kohën e lirë
- Bashkëpunimi prind-edukator-fëmijë
- Integrimi i fëmijeve në kopësht dhe marrja e nismave gjithëpërfshirëse në dobi të tyre
- Frekuentimi i fëmijeve në kopësht dhe vijueshmëria e tyre në grup

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Duke qenë se Këshilli i Prindërve përbën një prej aktorëve kryesorë të interesuar për një shërbim sa më të mirë të arsimit parashkollor dhe nëse funksionon vetëm formalisht, atëherë është e vështirë që shumë probleme të kopshteve, që kërkojnë edhe buxhet të madh, të jenë prioritet për Këshillin Bashkiak ose Bashkinë. Për këtë arsye është e nevojshme të trajtohen anëtarët e Këshillit të Prindërve çdo vit, në mënyrë që të adresojnë dhe ndjekin siç duhet problematikave të kopshtit.

ii Synimi i projektit

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

1. Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve. Në organizimin e aktiviteteve do të kërkohet përfshirja e anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe në këtë mënyrë do të rritet angazhimi i tyre në kopsht.
2. Pjesëmarrja e këshillit të prindërve në mbledhjet e Bashkisë

Për të fuqizuar Këshillin e Prindërve shihet tejet i nevojshëm dhe primar detajimi i Urdhrit Nr. 31, në të cilin duhet të vendosen edhe format e raportimit të Këshillit dhe rruga që ndiqet për t'i dhënë zgjidhje problemeve që mund të ngrihen nga Këshilli.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Hartimi i një protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të Këshillit dhe rrugës që Këshilli ndjek për t'i dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje. Detajimi nëpërmjet një udhëzimi të posaçëm siç është udhëzimi nr. 25 për Bordin e Kopshtit, që edhe këshilli për çështje të cilat kanë nevojë për zgjidhje nga bashkia, të raportojë pranë bashkisë.

B: Menaxheriale

1. Drejtorja e Arsimit organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës mbi të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Prindërve. Ky trajnim do të organizohet së bashku me trajnimin për Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit kështu që nuk do të ketë kosto shtesë;
2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Këshillit të Prindërve për t'i trajnuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre;
3. Drejtorja e Arsimit ndjek dhe asiston drejtuesit e kopshteve në trajnimet që ata kryejnë me Këshillin e Prindërve.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të Këshillit dhe rrugës që Këshilli i Prindërve ndjek për t'i dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje;
2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Drejtorja e Arsimit;
3. Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve nga drejtuesit e kopshteve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe drejtuesve;

2. Protokoll i unifikuar mbi mënyrën se si themelohet Këshilli i Prindërve, si raportohen çështjet që diskutohen gjatë mbledhjeve dhe si marrin zgjidhje.							
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Arsimit 				<ul style="list-style-type: none"> ZVAP OJF 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP)	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
2	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve	Drejtoria e Arsimit		0	135000	0	0
3	Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Drejtuesit e kopshteve		0	0	0	0
				0	135000	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2025				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit			

2.4.2 Bordi i Kopshtit

Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet publike të Bashkisë Dibër nga 86 kopshte të marra në analizë nuk e kanë themeluar Bordin e Kopshtit 25 kopshte, konkretisht 1 kopësht nga NjA Fushë-Çidhen, 1 kopësht nga NjA Kalaja e Dodës, 1 kopësht nga NjA Kastriot, 5 kopshte nga NjA Maqellarë, 2 kopshte nga NjA Melan, 2 kopshte nga NjA Tomin dhe 1 kopësht nga NjA Zall Dardhë.

Në kopshtet publike të Bashkisë Dibër, numri minimal i anëtarëve të bordit të kopshtit është 2, numri mesatar është 4 dhe numri maksimal është 8.

Në kopshtet e bashkisë Dibër, pjesa më e madhe e anëtarëve, i përkasin gjinisë “femër”, konkretisht numri mesatar i anëtarëve të gjinisë “femër” është 2, ndërsa numri mesatar i anëtarëve të gjinisë “mashkull” është 1.

Bordi mbledhet jo më pak se tri herë në vit. Mbledhjet e tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të bordit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij.

Ndërkohë disa nga detyrat e bordit dhe tematikat që duhet të diskutohen në Bord janë:

- Miratimin e planit afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit.
- Miraton planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni.
- Miraton kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor.
- Merrë pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të anëtarëve të bordit.
- Shqyrton rregulloren e brendshme të institucionit.
- Ndjekë përmbushjen e objektivave të planit vjetor të institucionit.
- Kontributi vullnetar i prindërve.
- Nevojat imediate të fëmijëve.
- Siguria e fëmijëve.
- Transporti i fëmijëve.
- Siguria e fëmijëve.
- Infastruktura.

Objektiva kryesore:

Themelimi dhe fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Bordit të Kopshtit në nivel Njësie Administrative
2	Rritja e aktivizimit të Bordit të Kopshtit në adresimin e problematikave të kopshtit

Nr	Pershkrimi
3	Adresimi i çështjeve të diskutuara në organizmat e kopshteve në Bashki

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
024	Numri i mbledhjeve të Bordit të Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare	3	3	4	5
024	Numri i mbledhjeve të Bordit të Kopshtit	Periferi	Vlere	Mesatare	2	3	3	5
024	Numri i mbledhjeve të Bordit të Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare	2	3	3	5
023	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare	0	1	1	2
023	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Periferi	Vlere	Mesatare	0	1	1	2
023	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare	0	1	1	2

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
022	Mbledhje të KB mbi arsimin parashkollor ku ka marrë pjesë Grupi Përfaqësues ndaj mbledhjeve totale mbi arsimin parashkollor	Bashki	Vlere	Tjeter	0	0	1	1
021	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Bordi i Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare	2	3	3	5
021	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Bordi i Kopshtit	Periferi	Vlere	Mesatare	1	2	3	4
021	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Bordi i Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare	0	1	2	3
020	Numri i anëtarëve në Bordin e Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare	5	6	6	7
020	Numri i anëtarëve në	Periferi	Vlere	Mesatare	4	5	5	5

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	Bordin e Kopshtit							
020	Numri i anëtarëve në Bordin e Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare	3	3	4	5
019	Numri i kopshteve që kanë Bordin e Kopshtit të përbashkët me Bordin e Shkollës	Qender	Vlere	Shumatore	0	0	0	0
019	Numri i kopshteve që kanë Bordin e Kopshtit të përbashkët me Bordin e Shkollës	Periferi	Vlere	Shumatore	0	0	0	0
019	Numri i kopshteve që kanë Bordin e Kopshtit të përbashkët me Bordin e Shkollës	Fshat	Vlere	Shumatore	0	0	0	0
018	Numri i kopshteve që kanë themeluar Bordin e Kopshtit	Qender	Vlere	Shumatore	2	2	2	2
018	Numri i kopshteve që	Periferi	Vlere	Shumatore	5	10	15	20

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	kanë themeluar Bordin e Kopshtit							
018	Numri i kopshteve që kanë themeluar Bordin e Kopshtit	Fshat	Vlere	Shumatore	3	20	30	47

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
009	Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve	Drejtorja e Arsimit		0	0	0	0
008	Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	Drejtorja e Arsimit		0	0	0	0
007	Ngritja e Bordit të Kopshtit sipas Udhëzimit nr. 25	Drejtorja e Arsimit		0	0	0	0

Listat e projekteve

Nr. 007	Projekti: Ngritja e Bordit të Kopshtit sipas Udhëzimit nr. 25	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Në kopshtet publike të Bashkisë Dibër nga 86 kopshte të marra në analizë nuk e kanë themeluar Bordin e Kopshtit 25 kopshte , konkretisht 1 kopësht nga NjA Fushë-Çidhen, 1 kopësht nga NjA		

Kalaja e Dodës, 1 kopësht nga NjA Kastriot, 5 kopshte nga NjA Maqellarë, 2 kopshte nga NjA Melan, 2 kopshte nga NjA Tomin dhe 1 kopësht nga NjA Zall Dardhë etj.

Në kopshtet publike të Bashkisë Diber, numri minimal i anëtarëve të bordit të kopshtit është 2, numri mesatar është 4 dhe numri maksimal është 8. Në kopshtet e qytetit të Dibrës, pjesa më e madhe e anëtarëve, i përkasin gjinisë “femër”, konkretisht numri mesatar i anëtarëve të gjinisë “femër” është 2, ndërsa numri mesatar i anëtarëve të gjinisë “mashkull” është 1.

Bordi mbledhet jo me pak se tri herë në vit. Mbledhjet e tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të bordit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Bordi i Kopshtit ka si synim të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Jo të gjitha kopshtet kanë numrin minimal të anëtarëve në Bordin e Institucionit Arsimor. Gjatë analizës vihet re qartë, që në disa kopshte Bordi nuk është krijuar. Është e rëndësishme që në themelimin e Bordit nëpër kopshte të tregohet vëmendje për numrin e anëtarëve.

ii Synimi i projektit

Është e nevojshme të ndërhyet për të themeluar Bordin e Kopshtit në kopshtet që ende nuk e kanë themeluar dhe të ndahet Bordi i Kopshtit nga ai i shkollave. Duke qenë se në NJA numri i fëmijëve të regjistruar është i vogël dhe kjo sjell vështirësi në themelimin e Bordit në secilin kopsht, është e nevojshme që të ngrihen kapacitetet e Bordit të Kopshtit në nivel Njësie Administrative.

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

1. Themelimi i Bordit në të gjitha kopshtet sipas Udhëzimit nr. 25
2. Ndarja e Bordit të Kopshtit nga ai i Shkollave.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Krijimi i një vendimi të posaçëm nga Drejtoria e Arsimit për ngritjen dhe funksionimin e Bordit në kopshte ku nuk ka drejtor, ku përcaktohet si person përgjegjës për këto detyra (të përcaktuara në Udhëzimin nr. 25, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të Institucionit Arsimor”) drejtuesi i 5 grupeve (Në projektin 025, është planifikuar

vendosja e 1 drejtuesi për të paktën 5 grupe për kopshtet që menaxhohen nga drejtuesit e arsimit bazë).

B: Menaxheriale

1. Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Drejtoria e Arsimit, njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit/kryemësuesit për themelimin e Bordit të Kopshtit brenda një afati 10 ditor.
2. Themelimi i Bordit të Kopshtit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Bordit në Bashki.
3. Drejtuesi i kopshtit njofton Drejtorinë e Arsimit sa herë që Bordi i Kopshtit mbledhet dhe çështjet që diskuton duke i dërguar procesverbalët ose dokumente të tjera shtesë të mbajtura nga Sekretari i Bordit.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Themelimi i Bordit të Kopshtit në nivel Njësie Administrative.
2. Monitorimi i themelimit dhe mbarëvajtjes së Bordit të Kopshtit nga Drejtoria e Arsimit

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Krijimi i Bordit në nivel NJA dhe funksioni i plotë i tij për kopshtet e Bashkisë Dibër;
2. Rritja e monitorimit të Bordit të Kopshtit nga ana e Bashkisë;
3. Ndarja e Bordit të Kopshtit nga Bordi i Shkollës.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Arsimit
- Kryetari i Bashkisë

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Bordi i Kopshteve
- Drejtuesit e kopshteve

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht	Drejtorja e Arsimit		0	0	0	0
2	Monitorimi i themelimit dhe	Drejtorja e Arsimit		0	0	0	0

	mbarëvajtjes së Bordit të Kopshtit						
				0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2025				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtorja e Arsimit			

Nr. 008	Projekti: Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
---------	--	--

a)Përshkrim i shkurtër i projektit

i Situata

Numri minimal i mbledhjeve të Bordit në Kopshtet publike të Bashkisë Dibër është 2, numri mesatar është 4, ndërsa numri maksimal është 8. Mbledhja e bordit të kopshtit në disa kopshte realizohet më pak nga sa është e parashikuar me ligj. Kjo mund të vijë si pasojë e mungesës së informacionit të anëtarëve të bordit mbi kompetencat dhe detyrimet e tyre.

Ndërkohë disa nga detyrat e bordit dhe tematikat që diskutohen në Bord janë:

- Miratimin e planit afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit.
- Miraton planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni.
- Miraton kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor.
- Merrë pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të anëtarëve të bordit.
- Shqyrton rregulloren e brendshme të institucionit.
- Ndjekë përmbushjen e objektivave të planit vjetor të institucionit.
- Kontributi vullnetar i prindërve.
- Nevojat imediate të fëmijëve.
- Siguria e fëmijëve.
- Transporti i fëmijëve.
- Siguria e fëmijëve.
- Infastruktura.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Bordi i Kopshtit ka si synim të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose

adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

ii Synimi i projektit

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

1. Fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.
2. Themelimi i Bordit të Kopshtit në nivel Njësie Administrative dhe ndarja e Bordit nga Shkollat.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Drejtoria e Arsimit organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrat e bordit të kopshtit;
2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e bordit për t'i trajnuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre.
3. Drejtoria e Arsimit ndjek dhe asistondrejtesit e kopshteve në trajnimet që ata kryejnë me Bordin e Kopshtit.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve/mësuesve përgjegjës nga Drejtoria e Arsimit. Kostot për një person janë 1.5 mijë lekë.
2. Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit nga drejtuesit e kopshteve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Bordit të Kopshteve dhe drejtuesve;
2. Rritja e ndikimit të Bordit të Kopshtit në menaxhimin e kopshteve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Arsimit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve/mësuesve përgjegjës	Drejtorja e Arsimit	0	0	45000 leke	0	45000
2	Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Drejtuesit e Kopshteve	0	0	50 000	0	50000
				0	95000	0	95000
f) Periudha e zbatimit: 2025-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtorja e Arsimit			

Nr. 009	Projekti: Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Edhe pse pjesa më e madhe e kopshteve të Bashkisë Dibër e kanë ngritur Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, nuk është e qartë se si temat që diskutojnë dhe problematikat që evidentojnë adresohen në Bashki për të gjetur zgjidhje.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Në një pjesë të kopshteve duket sikur organizmat e mësipërm funksionojnë vetëm formalisht. Kjo do të thotë se nevojat e kopshteve të evidentuara në takime nuk adresohen në Bashki dhe		

nuk diskutohen në Këshillin e Bashkisë për të gjetur zgjidhje. Për këtë arsye është e nevojshme të ndërtohet një urë komunikimi mes këtyre organizmave dhe Bashkisë.

ii Synimi i projektit

Për anëtarët e Këshillit, Bordit dhe Komisionit të kopshteve pranë NJA, mund të jetë e vështirë pjesëmarrja në takimet e Këshillit të Bashkisë kur diskutohet buxheti apo planifikohen investimet. Duke munguar një zë në këto takime që thekson problematikat e kopshteve, shihet e vështirë gjetja e zgjidhjeve të tyre.

Ndaj, nëpërmjet këtij projekti synohet që të krijohet një grup përfaqësues me pjesëmarrës nga Këshillat e Prindërve, Bordeve të Kopshteve dhe Komisioneve nga të gjitha kopshtet e Bashkisë, që do të ketë kontakte me të gjitha organizmat në gjithë kopshtet dhe do të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak sa herë diskutohen eështje që lidhen me arsimin parashkollor. Në këtë mënyrë synohet që të ngrihet zëri mbi problematikat e kopshteve dhe të gjenden zgjidhje për to.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Drejtoria e Arsimit krijon një rregullore mbi të drejtat dhe detyrat e Grupit Përfaqësues, mënyrën e raportimit, mënyrën e njoftimit për mbledhje, etj.

B: Menaxheriale

1. Sapo në të gjitha kopshtet janë themeluar Këshilli, Bordi dhe Komisioni, krijohet Grupi Përfaqësues. Grupi Përfaqësues nuk ka minimum dhe maksimum anëtarësh. Anëtarët mund të jenë nga Çdo kopsht apo organizëm dhe pjesëmarrja në tështë vullnetare;
2. Kur ky grup formohet, drejtuesit e kopshteve (të trajnuar tashmë nga Bashkia) informojnë anëtarët mbi të drejtat, detyrimet dhe protokollin e adresimit të njëçështjeje.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i rregullores për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Përfaqësues;
2. Krijimi i Grupit Përfaqësues;
3. Informimi i anëtarëve të Grupit nga drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrimet.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Ngritja e një grupi përfaqësues i 3 organizmave të kopshteve, që do të përfaqësojë kopshtet në nivelin vendor;
2. Përfaqësimi më i madh i kopshteve në Bashki

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)				Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)			
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Arsimit 				<ul style="list-style-type: none"> OJF 			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i rregullores për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Përfaqësues	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
2	Krijimi i Grupit Përfaqësues	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
3	Informimi i anëtarëve të Grupit mbi të drejtat dhe detyrimet	Drejtuesit e Kopshteve		0	0	0	0
				0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit			

2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

Informacion i përgjithshëm

Pjesa më e madhe e kopshteve publike, respektivisht 24 kopshte nga 86 të marra në analizë nuk e kanë themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, 17 prej tyre nuk kanë dhënë një përgjigje dhe vetëm 3 kopshte e kanë themeluar.

Ndërkohë përsa i takon mbledhjeve të komisionit për t'i dhënë zgjidhje problematikave të krijuara në kopsht ai duhet të mblidhet për të diskutuar problemet. Sipas analizës së të dhënave komisioni është mbledhur mesatarisht 3 herë.

Kopshtet e NJA dhe që janë brenda godinave të shkollave menaxhohen nga drejtuesit e shkollave dhe kanë të integruar Komisionin e Shëndetit të tyre me Komisionin e Shkollës.

Objektiva kryesore:

Themelimi dhe fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit sipas Udhëzimit nr. 31.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në nivel Njësie Administrative dhe ndarja e Komisionit të Kopshtit nga ai i Shkollës
2	Fuqizimi i Komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
030	Kopshte që kanë hartuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit	Qender	Vlere	Shumatore	0	1	0	0
030	Kopshte që kanë hartuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit	Periferi	Vlere	Shumatore	0	1	0	0
030	Kopshte që kanë hartuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit	Fshat	Vlere	Shumatore	0	1	0	0

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
029	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Komisioni i Shëndetit	Qender	Vlere	Mesatare	0	1	1	2
029	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Komisioni i Shëndetit	Periferi	Vlere	Mesatare	0	0	1	2
029	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Komisioni i Shëndetit	Fshat	Vlere	Mesatare	0	0	1	2
028	Numri i anëtarëve në Komisionin e Shëndetit	Qender	Vlere	Mesatare	3	3	4	5
028	Numri i anëtarëve në Komisionin e Shëndetit	Periferi	Vlere	Mesatare	1	2	3	4
028	Numri i anëtarëve në Komisionin e Shëndetit	Fshat	Vlere	Mesatare	0	1	2	3

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
027	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Komisionit të Shëndetit	Qender	Vlere	Mesatare	0	1	2	3
027	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Komisionit të Shëndetit	Periferi	Vlere	Mesatare	0	0	1	2
027	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Komisionit të Shëndetit	Fshat	Vlere	Mesatare	0	0	1	2
026	Kopshtet që e kanë Komisionin e Shëndetit të integruar në Komisionin e Shkollës	Qender	Vlere	Shumatore	2	2	2	2
026	Kopshtet që e kanë Komisionin e Shëndetit të integruar në Komisionin e Shkollës	Periferi	Vlere	Shumatore	3	3	3	3
026	Kopshtet që e kanë Komisionin e Shëndetit të integruar në	Fshat	Vlere	Shumatore	2	2	2	2

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	Komisionin e Shkollës							
025	Kopshtet që kanë themeluar Komisionin e Shëndetit	Qender	Vlere	Shumatore	2	2	2	2
025	Kopshtet që kanë themeluar Komisionin e Shëndetit	Periferi	Vlere	Shumatore	4	8	10	15
025	Kopshtet që kanë themeluar Komisionin e Shëndetit	Fshat	Vlere	Shumatore	4	10	20	30

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
011	Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Drejtoria e Arsimit		0	4500	0	0
010	Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0

Listae projekteve

<p>Nr. 010</p>	<p>Projekti: Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit</p>	<p>Programi Buxhetor:09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</p> <p>Funksioni: 09</p>
<p>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</p>		
<p>i Situata</p> <p>Pjesa më e madhe e kopshteve publike, respektivisht 24 kopshte nuk e kanë themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, 17 prej tyre nuk kanë dhënë asnjë informacion dhe vetëm 10 kopshte e kanë themeluar.</p> <p>Kopshtet e NJA dhe që janë brenda godinave të shkollave menaxhohen nga drejtuesit e shkollave dhe kanë të integruar Komisionin e Shëndetit të tyre me Komisionin e Shkollës.</p>		
<p>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</p>		
<p>Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (<i>sipas Urdhërit nr. 31 "Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"</i>) janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton nevojat për ndrejtje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuese me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.</p> <p>Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe mungesa e Komisionit bën që këto detyra të mos mbulohen fare ose të mbulohen pjesërisht. Gjithashtu, për kopshtet brenda godinave të shkollave ku Komisioni është i integruar me Komisionin e Shkollës shkakton të njëjtën problematikë.</p>		
<p>ii Synimi i projektit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Themelimi i Komisionit në çdo kopsht; 2. Ndarja e Komisionit të Kopshtit nga ai i Shkollës; 3. Informimi i Bashkisë rreth problemeve dhe tematikave, të cilat diskutohet në Komision, por që është e nevojshme ndërhyrja e Bashkisë për t'i dhënë zgjidhje. 		
<p>iii Niveli i ndërhyrjes</p> <p>A: Ligjore</p>		

1. Krijimi i një vendimi të posaçëm për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Shëndetit, për kopshtet ku nuk ka drejtor, ku përgjegjësia e themelimit të Komisionit sipas Udhëzimit nr. 31 i kalon një mësuesi.
2. Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ku kompetencën për themelimin dhe monitorimin e Komisionit të Shëndetit e ka Drejtoria e Arsimit pranë Bashkisë.

B: Menaxheriale

1. Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Drejtoria e Arsimit, njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit për themelimin e Komisionit të Shëndetit brenda një afati 10 ditor.
2. Themelimi i Komisionit të Shëndetit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Komisionit në Bashki.
3. Drejtuesi i kopshtit/mësuesi përgjegjës plotëson në Platformën Digjitale/njofton Drejtorinë e Arsimit sa herë që Komisioni mbledhet dhe çështjet që diskuton.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Themelimi i Komisionit të Shëndetit në nivel Njësie Administrative;
2. Monitorimi i procesit të themelimit dhe mbarëvajtjes së Komisionit nga Drejtoria e Arsimit.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Krijimi i Komisionit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht
2. Ndarja e Komisionit të Kopshtit nga ai i Shkollave.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Arsimit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit çdo vit në	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0

	çdo kopsht sipas Udhëzimit Nr. 31						
2	Monitorimi i procesit të themelimit dhe mbarëvajtjes së Komisionit	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
				0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit			

Nr. 011	Projekti: Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Sipas Udhëzimit nr. 31, përsa i takon mbledhjeve të komisionit për t'i dhënë zgjidhje problematikave të krijuara në kopsht ai duhet të mbledhet për të diskutuar problemet. Mesatarisht Komisioni është mbledhur 3 herë në vit në kopshtet publike të bashkisë Dibër.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 „Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë“) janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjedisëve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për		

shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuere me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.

Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe funksionimi vetëm formal i tij bën që këto detyra të mos mbulohen fare ose të mbulohen pjesërisht.

ii Synimi i projektit

1. Fuqizimi i Komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Drejtorja e Arsimit organizon një trajnim për drejtuesit e kopshtit për të drejtat dhe detyrimet e Komisionit, mënyrën e adresimit të problemeve, etj.
2. Drejtuesit e Kopshteve/mësuesit përgjegjës organizojnë takime informuese me anëtarët e Komisionit për të drejtat, detyrimet e tyre dhe mënyrën e adresimit të problemeve

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Drejtorja e Arsimit;
2. Trajnimi i anëtarëve të Komisionit nga drejtuesit e kopshteve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit dhe drejtuesve të kopshteve;
2. Rritja e përfaqësimit të çështjeve që lidhen me kopshtet në Bashki.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtorja e Arsimit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Trajnimi i drejtuesve të kopshteve	Drejtoria e Arsimit	0	0	4500	0	4500
2	Trajnimi i anëtarëve të Komisionit	Drejtuesit e kopshteve	0	0	0	0	0
			0	0	4500	0	4500
f) Periudha e zbatimit: 2025				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit			

3.Proceset Kryesore- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

3.1 Qëllimi

Proceset kryesore janë ato procese që i shërbejnë drejtpërdrejt përbushjes së objektivave strategjike ose qëllimit të institucionit. Këto procese ofrojnë një pjesë të konsiderueshme të performancës së një institucioni dhe konsumojnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve. Në lidhje me kopshtet publike, fëmijët regjistrohen dhe mbërrijnë në objekt (këtu fillon procesi) dhe largohen pasi të kenë marrë arsimin parashkollor (procesi përfundon).

Plani i përmirësimit të shërbimit ka si qëllim rritjen e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit më të mirë të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, fëmijë viktime të dhunës dhe abuzimit, etj), fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

3.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesore të planeve të përmirësimit në lidhje me Proceset Kryesore janë:

1. Rritja e identifikimit dhe vlerësimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar;
2. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar;
3. Hartimi i politikave dhe ofrimit të paketës së shërbimeve për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe në moshë për kopësht për lehtësimin e aksesit të tyre në kopësht;
4. Ofrimi i ndihmës profesionale dhe stimuluesepër fëmijët e grupmoshës 3-6 vjeç dhe jo vetëm, si pjesë e ndërhyrjes së hershme

5. Rritja e kapaciteteve ndërgjegjësuere dhe reaguese të anëtarëve të bordeve të institucioneve arsimore dhe këshillit të prindërve për rolin e tyre dhe njohjen me mekanizmat mbështetës
6. Mbështetje për kategori të caktuara në nevojë me paketa lehtësuere me tarifa të ulura ose falas për stimulimin e frekuentimit të kopshteve me drekë për komunitetet në nevojë, përfshirë edhe ato romë dhe egjiptiane

3.4 Mbrojtja e fëmijëve

3.4.1 Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës

Informacion i përgjithshëm

Në Bashkinë Dibër nuk ka asnjë punonjës social për mbrojtjen e fëmijës të punësuar. Në Njësitë Administrative nuk ka PMF por ka administrator social të cilët mbulojnë NjA. Bashkia ka një qendër sociale për mbrojtjen e fëmijëve në bashkëpunim me Save the Children. Gjithashtu ka paketa lehtësuere për fëmijët në nevojë dhe ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh që përfitojnë prej këtyre paketave.

Nuk kemi të dhëna në nivel Bashkie mbi numrin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të cilët janë të regjistruar dhe frekuentojnë çdo ditë kopshtin.

Objektiva kryesore:

Parandalimi, identifikimi, raportimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve punojnë ngushtësisht me stafet e kopshteve për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve nëpërmjet GTN (grupeve teknike ndërsektorale) për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve por edhe trajtimin në vazhdimësi të tyre
2	Organizimi i paketave trajnuese për stafet e punonjësve për t'u njohur me shërbimet mbrojtëse për fëmijët dhe kryesisht të rolit të tyre në të gjithë këtë process.
3	Vendosja e PMF në kontakt me stafin e kopshteve në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve

Nr	Pershkrimi
4	Çdo kopsht ka të hartuar, të miratuar dhe të njohur nga stafet, politikat e mbrojtjes së fëmijëve.

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
042	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve	Qender	Vlere	Mesatare	0	10	15	30
042	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve	Periferi	Vlere	Mesatare	0	5	10	20
042	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve	Fshat	Vlere	Mesatare	0	5	20	40
041	Kopshtet që kanë hartuar dhe njohin politikat e mbrojtjes së fëmijëve (%)	Qender	%	Tjeter	0	10	15	30
041	Kopshtet që kanë hartuar dhe njohin politikat e	Periferi	%	Tjeter	0	10	15	20

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	mbrojtjes së fëmijëve (%)							
041	Kopshtet që kanë hartuar dhe njohin politikat e mbrojtjes së fëmijëve (%)	Fshat	%	Tjeter	0	10	15	30
039	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të identifikuar nga stafi i kopshtit (%)	Qender	%	Tjeter	15	20	20	25
039	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të identifikuar nga stafi i kopshtit (%)	Periferi	%	Tjeter	10	15	20	25
039	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të identifikuar nga stafi i kopshtit (%)	Fshat	%	Tjeter	10	15	15	30
038	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të regjistruar në kopsht (%)	Qender	%	Tjeter	10	15	15	30
038	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të	Periferi	%	Tjeter	10	15	20	30

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	regjistruar në kopsht (%)							
038	Fëmijë në nevojë për mbrojtje të regjistruar në kopsht (%)	Fshat	%	Tjeter	10	15	20	30
036	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar nga PMF	Qender	Vlere	Shumatore	5	5	10	20
036	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar nga PMF	Periferi	Vlere	Shumatore	5	15	15	30
036	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar nga PMF	Fshat	Vlere	Shumatore	5	10	20	40
037	Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje në moshë kopshti	Qender	Vlere	Shumatore	7	8	8	9
037	Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje në moshë kopshti	Periferi	Vlere	Shumatore	5	7	7	7
037	Numri i fëmijëve në nevojë për	Fshat	Vlere	Shumatore	10	12	12	15

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	mbrojtje në moshë kopshti							

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
014	Vendosja dhe promovimi i një punonjësi të dedikuar në çdo institucion të arsimit parashkollor i cili do të kujdeset për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion	Njësia e Arsimit Parashkollor	0	606000	606000	606000	606000
013	Hartimi i një dokumenti mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve përshtatur me gjuhën e kuptueshme për fëmijët	Drejtoria e Shërbimit Social	0	0	0	0	0
012	Shtimi i psikologëve në Njësinë e Arsimit Parashkollor	Njësia e Arsimit Parashkollor	0	606000	606000	606000	606000

Listae projekteve

Nr. 012	Projekti: Shtimi i psikologëve në Njësinë e Arsimit Parashkollor	Programi Buxhetor: 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët Funksioni: 10
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Në Bashkinë Dibër për kopshtet, per vitin 2023 nuk ka asnjë psikolog/punonjës social. Psikologu i shkollës mund të organizoj ndonjë aktivitet dhe për kopshtet.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Shërbimi psiko-social është i përbërë nga psikologë dhe punonjës social, të cilët kanë një numër të caktuar nxënësish ku përfshihen dhe fëmijët në grupmoshën e kopshtit dhe që i frekuentojnë ato gjithashtu. Është evidentuar se për shkak të numrit të kufizuar dhe kërkesave gjithmonë në rritje për vëmendje dhe kujdes psikosocial, fëmijët në kopshte marrin një kujdes të cunguar ose të munguar në trajtimin psiko-social.</p> <p>Duke i dhënë fokus trajtimit të problematikave të fëmijëve si parandalim në moshën e hershme, është e nevojshme që të ketë punonjës të dedikuar për trajtimin e problematikave psiko-sociale për fëmijët në moshë kopshti në strukturën e Njësisë së Arsimit Parashkollor.</p>		
ii Synimi i projektit		
<p>Në Bashkinë Dibër janë të regjistruar 1831 fëmijë në kopsht. Në raport me numrin e fëmijëve numri i psikologëve është i ulët. Duke përcaktuar 1 psikolog për 500 fëmijë është e nevojshme shtimi i psikologëve për Njësitë Administrative në të cilat mungon shërbimi psikosocial, në këtë mënyre do të trajtohen më mirë problematikat psiko-sociale të fëmijëve.</p> <p>Psikologët përveçse duhet të ofrojnë mbështetje psiko-sociale synohet që njëkohësisht të raportojnë pranë PMF-së, rastet e fëmijëve në rrezik për abuzim të identifikuar gjatë trajtimit.</p> <p>Pra, me punësimin e psikologëve shtesë synohet të:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Ofrohet shërbim cilësor dhe profesional i dedikuar për fëmijët në moshë kopshti;2. Mbulim më i mirë i nevojave të fëmijëve që kanë nevojë për trajtim;3. Rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përfshirje sociale.		
iii Niveli i ndërhyrjes		
A: Ligjore		

1. Propozimi pranë KB për punësimin e psikologëve të dedikuar për fëmijët e kopshteve në Njësitë Administrative;
2. Miratimi nga KB i buxhetit për punësimin e psikologëve të dedikuar për fëmijët e kopshteve në Njësitë Administrative;
3. Kontratë pune mes Bashkisë dhe Psikologëve.

B: Menaxheriale

1. Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse punëson psikologët sipas procedurave të brendshme;
2. Psikologët e dedikuar për kopshtet hartojnë planet e punës, vizitat në terren, këshillimin dhe trajtimin e rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale dhe vizita dhe takime me fëmijët e kopshteve për të vlerësuar nevojat e tyre psiko-sociale.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

- 1. Marreveshje me ZVA për përdorimin e psikologëve të shkollave edhe për kopshtet për të gjitha kopshtet që ndodhen brenda ambienteve të shkolles**
2. Propozimi në KB për punësimin e psikologëve të rinj;
3. Punësimi i psikologëve të rinj. Paga për 1 psikolog është 50,500 lekë. Vizita në terren nga psikologët për vlerësimin psiko-social të fëmijëve dhe trajtimin e rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Rritje e numrit të fëmijëve që marrin shërbime;
2. Rritje e numrit të fëmijëve të raportuar pranë PMF;
3. Rritje e numrit të fëmijëve që marrin shërbime të specializuara sipas nevojave;
4. Çdo fëmijë që frekuenton kopshtin dhe merr trajtim psikosocial, ka dosjen e vet individuale, ku përfshihen praktika e vlerësimit dhe planit të ndërhyrjes.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Shërbimit Social
- Drejtoria e burimeve njerëzore

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Marreveshja me ZVA per mbulimin e rasteve te kopeshteve nga psikologët e shkollave ne zona te thella	Njësia e Arsimit Parashkollor	0	0	0	0	0
2	Punësimi i nje psikologu ae do mbuloje dhe arsimin parashkollor	Njësia e Arsimit Parashkollor	0	606000	606000	606000	606000
3	Vizita në terren nga psikologët për vlerësimin psiko-social të fëmijëve	Njësia e Arsimit Parashkollor	0	0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2025			g) Ndjek zbatimin e projektit: Njësia e Arsimit Parashkollor				

Nr. 013	Projekti: Hartimi i një dokumenti mbi politikat e mbrojtjes së fëmijëve përshtatur me gjuhën e kuptueshme për fëmijët	Programi Buxhetor: 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët Funksioni: 10
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		

Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Ligji shpreh qartësisht mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës në të gjitha format dhe mënyrat dhe dokumenti i politikave të mbrojtjes së fëmijëve garanton që në të gjitha sistemet dhe atë të sistemit të arsimit parashkollor të jetë i familjarizuar më të gjitha praktikrat dhe procedurat për parandalimin e formave të abuzimit, identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, raportimin dhe trajtimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Zinxhiri i komunikimit mes kopshtit dhe Bashkisë nuk është i qartë në kopshtet që menaxhohen nga drejtorët e shkollave të arsimit bazë. Gjithashtu, një pjesë e këtyre kopshteve menaxhohet nga një mësuese e cila zhvillon edhe mësim, çka vështirëson akoma më shumë komunikimin kopsht-bashki.

NJMF pranë Drejtorisë së Shërbimit Social dhe PMF duhet të sigurohen që ligji 18/2017 është i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë stafin e kopshteve dhe bashkisë që janë në kontakt me fëmijët. Për këtë arsye, është e nevojshme të hartohet një dokument bazuar në këtë ligj mbi politikën e mbrojtjes së fëmijëve, të përshtatur në gjuhë të kuptueshme jo vetëm për stafin e kopshteve, por edhe për vetë fëmijët, prindërit dhe partnerët e tjerë.

ii Synimi i projektit

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të jetë një dokument udhëheqës për stafet, prindërit, partnerët e vullnetarët në institucionet edukative parashkollore nën administrimin e bashkive në të cilat punohet me / për fëmijë, për të mbrojtur dhe ruajtur mirëqënien e fëmijëve nga çdo formë e dhunës apo abuzimit.

Ky dokument synon të nxisë garantimin e një sjelljeje institucionale, më të përgjegjshme në kopshtet dhe jo vetëm në bashki në funksion të krijimit të ambjenteve më të sigurta për të gjithë fëmijët.

Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve ka udhëzime dhe procedura të qarta të cilat do t'i ndihmojnë stafet kopshteve në identifikimin e rasteve të abuzimit në mjediset e institucionit si dhe raportimin apo referimin e çdo rasti të abuzimit të fëmijëve. Këto procedura duhet të jenë të qarta edhe për bordet drejtuese dhe këshillin e prindërve.

Rëndësia e kësaj politike shtrihet në qartësimin e roleve, përgjegjësisve, procedurave dhe rregullave për shqetësime që dalin lidhur me mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, ajo do të ndihmojë kopshtet të përmbushin detyrimet ligjore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Miratimi i dokumentit mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijës në Këshillin Bashkiak;
2. Ky dokument bëhet pjesë e kontratës së çdo mësuesi, ku këta të fundit nënshkruajnë për kuptueshmërinë e tij dhe mbajnë përgjegjësi për të

B: Menaxheriale

1. Drejtorja e Shërbimit Social, NJMF dhe PMF dhe në bashkëpunim me ZVAP dhe/ose OJF të profilizuara në fushën e arsimit ngre grupin e punës për përgatitjen e dokumentit, duke u përkujdesur që të përfshijë dhe specifika që lidhen me kulturën dhe kontekstin e secilës zonë;
2. Kryhen konsultime me mësues dhe prindër për të finalizuar më pas dokumentin.
3. Dokumenti kalon për miratim në KB;
4. Pjesë e dokumentit është kodi i sjelljes së çdo punonjësi që është në kontakt me fëmijën, si praktikantë, vullnetarë, mësues, etj;
5. Vendoset personi i kontaktit në çdo kopsht për mbrojtjen e fëmijëve duke përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e tij (Projekt fisha nr 022);
6. Hartohen procedurat për raportimin e shqetësimeve dhe incidenteve për mbrojtjen e fëmijëve;
7. Hartimi i një aneksi brenda dokumentit për sjelljen dhe trajtimin që duhet të ketë media në çështje që lidhen me fëmijët.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Ngritja e Grupit të Punës për hartimin e dokumentit;
2. Konsultimi me prindër dhe mësues;
3. Miratimi në KB;
4. Promovimi i dokumentit në të gjitha strukturat e nevojshme;
5. Informim i stafit të kopshtit për politikën e mbrojtjes së fëmijëve

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Hartimi i dokumentit mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve;
2. Njohja më e mirë e stafit të kopshteve, prindërve dhe fëmijëve me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve;
3. Pajisja e çdo kopshti me një praktikë të miratuar ligjore të përshtatur sipas grupmoshës së fëmijëve në kopsht që siguron mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

Drejtoria e Shërbimit Social (NJMF, PMF)				• OJF			
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Ngritja e Grupit të Punës	Drejtoria e Shërbimit Social		0	0	0	0
2	Konsultimi me prindër dhe mësues	Drejtoria e Shërbimit Social		0	0	0	0
3	Miratimi në KB	Drejtoria e Shërbimit Social		0	0	0	0
4	Promovimi i dokumentit në të gjitha strukturat e nevojshme	Drejtoria e Shërbimit Social		0	0	0	0
5	Informim i stafit të kopshtit për politikat e mbrojtjes së fëmijëve	Drejtoria e Shërbimit Social		0	0	0	0
				0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2025				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Shërbimit Social			

Nr. 014	Projekti: Vendosja dhe promovimi i një punonjësi të dedikuar në çdo institucion të arsimit parashkollor i cili do të kujdeset për zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucion	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
---------	--	--

a)Përshkrim i shkurtër i projektit

i Situata

Pjesa më e madhe e kopshteve publike në territorin e Bashkisë Dibër ndodhen brenda godinave të shkollave. Në Bashkinë Dibër ka 70 kopshte funksionojnë brenda shkollave, ndërkohë që kemi marr në analizë 86 kopshte publike.

Është me rëndësi që në çdo kopsht një staf mësues apo përgjegjes të jetë më tepër i vëmendshëm për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të njohë procedurën e identifikimit dhe raportimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Është e nevojshme që stafi i kopshteve të njihet me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe mënyrat e identifikimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Gjithashtu, është e rëndësishme që stafi të jetë i njohur me mënyrën e referimit të çdo rasti të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në Bashki.

Për këtë qëllim është e nevojshme që të paktën një staf i kopshteve të ketë njohuritë e duhura për identifikimin dhe raportimin e rasteve të fëmijëve në rrezik apo në nevojë për mbrojtje që frekuentojnë kopshtin ashtu sikundër ndjek rastet e fëmijëve të regjistruar në kopësht dhe që janë identifikuar dhe në ndjekje nga PMF.

ii Synimi i projektit

Për të rritur numrin e fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe për të siguruar trajtimin e çështjes së tyre në mënyrë efikase është e rëndësishme që stafi i kopshtit të njihet me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të vendoset një person kontakti në çdo kopsht, që do të jetë përgjegjës për zbatimin e saj (për tu njohur me kanalet e raportimit dhe identifikimit dhe përgjegjësitë që ju takon sipas ligjit).

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Çdo kopsht nën administrimin e Njesisë së Arsimit Parashkollor vendos personin e kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve;
2. Të dhënat e Personave të Kontaktit dërgohen pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve të Bashkisë dhe PMF të NJA menjëherë pas aprovimit zyrtar të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve nga Njësia e Arsimit Parashkollor;
3. Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve në kopsht bëhet pjesë e mekanizmit të identifikimit dhe menaxhimit të rasteve;
4. Roli i këtij personi është të shërbejë si një pikë kontakti, dhe të këshillojë, mbështesë dhe ndihmojë stafet në kopshte dhe çerdhe në zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve;

5. Personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve në kopsht është burimi i parë i këshillimit dhe përkrahjes në lidhje me çështjet për mbrojtjen e fëmijëve dhe zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve;
6. Bashkia do të vërë në dispozicion informacion të vazhdueshëm dhe profesional për kopshtet për mbrojtjen e fëmijëve;
7. Organizimi i trainimeve të veçanta për Personat e Kontaktit për të rritur kapacitetet e tyre mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve. Trainimet organizohen nga PMF.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Përcaktimi i Personit të Kontaktit nga Njësia e Arsimit Parashkollor;
2. Dërgimi i të dhënave të Personit të Kontaktit në NJMF në Bashki dhe PMF në NJA;
3. Organizimi i trainimit të Personave të Kontaktit nga drejtuesit e kopshteve (të trainuar më parë nga NJMF) për rritjen e kapaciteteve mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Rritja e numrit të fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje.
2. Rritje e kapaciteteve të stafit të kopshteve në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.
3. Menaxhimi efikas i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit (NJMF, PMF)
- Njësia e Arsimit Parashkollor

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Përcaktimi i Personit të Kontaktit	Njësia e Arsimit Parashkollor		0	0	0	0
2	Dërgimi i të dhënave te NJMF	Njësia e Arsimit Parashkollor		0	0	0	0

3	Trainimi i Personave të Kontaktit	Njësia e Arsimit Parashkollor			10000	0	10000
				10000	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024				g) Ndjek zbatimin e projektit: Njësia e Arsimit Parashkollor			

3.4.2 Shërbimi bashkiak i mbrojtjes së fëmijës

Informacion i përgjithshëm

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe shërbimi psikosocial janë njësi me shumë rëndësi për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në moshë për kopsht. Është me rëndësi që këto dy struktura të jenë funksionale dhe ndërveprojnë ngushtë për çdo fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje që frekuenton kopshtin.

Njesia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit ka në përbërjen e saj: një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6000 deri në 10 000 banorë; një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3000 fëmijë; një administrator shoqëror; nenpunësin gjinor/koordinator dhune

Aktualisht në bashkinë Dibër kjo njësi nuk është e është e ngritur në asnjë prej Njësive Administrative.

Gjithashtu, është evidentuar se për shkak se nuk ka asnjë psikolog dhekërkesat gjithmonë në rritje për vëmendje dhe kujdes psikosocial, fëmijët në kopshte nuk marrin një kujdes në trajtimin psiko-social.

Objektiva kryesore:

- Ofrimin e një shërbimi cilësor në kopsht që garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në çdo kohë, jo vetëm gjatë raportimit, por përgjatë gjithë kohëqëndrimit në kopsht të fëmijës.
- Trajtimin e rasteve të fëmijëve të marrë në mbrojtje që janë të regjistruar dhe frekuentojnë kopshtin.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve punojnë ngushtësisht me stafet e kopshteve për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve nëpërmjet GTN (grupeve teknike ndërsektoriale) për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve por edhe trajtimin në vazhdimësi të tyre

Indikatorët e performancë

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
036	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar nga PMF	Qender	Vlere	Mesatare	0	10	15	20
036	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar nga PMF	Periferi	Vlere	Mesatare	0	5	10	15
036	Numri i stafit të kopshtit i trajnuar nga PMF	Fshat	Vlere	Mesatare	0	5	20	40
044	Fëmijë në nevojë për mbrojtje që kanë marrë shërbimin e psikologut (%)	Qender	%	Tjeter	0	5	20	30
044	Fëmijë në nevojë për mbrojtje që kanë marrë shërbimin e psikologut (%)	Periferi	%	Tjeter	0	0	10	20
044	Fëmijë në nevojë për mbrojtje që kanë marrë shërbimin e psikologut (%)	Fshat	%	Tjeter	0	0	5	10
046	PIM të hartuara për fëmijët në nevojë për	Qender	%	Tjeter	0	5	8	10

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	mbrojtje ndaj numrit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (%)							
046	PIM të hartuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje ndaj numrit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (%)	Periferi	%	Tjeter	0	5	7	8
046	PIM të hartuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje ndaj numrit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (%)	Fshat	%	Tjeter	0	5	6	7

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
017	Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	Drejtoria e Shërbimit Social		0		0	0
016	Promovimi i rolit dhe	Kujdesi social për		0		0	0

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
	detyrave te PMF	familjet dhe fëmijët					
015	Punësimi i PMF për çdo Njësi Administrative dhe rajon	Drejtoria e Sherbimit Social		0	0	8904000	Pagex12 muajx14njesi

Listae projekteve

Nr. 015	Projekti: Punësimi i PMF për çdo Njësi Administrative dhe rajon	Programi Buxhetor: 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët Funksioni: 10
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Në Bashkinë Dibër nuk ka PMF por funksjonojnë administratorët social, të cilëve u janë deleguar detyrat si PMF.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Për shkak të mungesës së grupeve të terrenit proaktive për identifikimin e fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale dhe mungesës e një punonjësi social që të kryejë vetëm rolin e PMF, identifikimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje ka qenë i vështirë. Funksionimi i kësaj drejtorie vetëm me administrator social e ka bërë të pamundur menaxhimin efikas të rasteve të ndryshme që kanë nevojë për trajtim më të dedikuar.		
ii Synimi i projektit		
Në këtë projekt planifikohet punësimi i PMF-ve me profil punonjës social, në një hark kohor prej 3 vjetësh, të cilët do të kenë si detyra vetëm çështje që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë mënyrë synohet që të rritet numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje dhe efikasiteti i menaxhimit të secilit prej rasteve. Ngelet në gjykim të Bashkisë Dibër, numri i PMF-ve të emëruar gjithmonë duke marrë në konsideratë Ligjin nr. 18/2017 ¹ , neni 50, ku çdo Njësi Administrative e Bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, ka minimalisht, një		

¹ Ligj nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

punonjës për mbrojtjen e fëmijës. Në rastet kur Njësia Administrative e Bashkisë ka më pak se 3000 fëmijë, këtë detyrë mund ta kryejë njëri nga punonjësit e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Miratimi në KB i planit dhe buxhetit 3-vjeçar të punësimit të PMF-ve.

B: Menaxheriale

1. Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore përgatit planin dhe buxhetin 3-vjeçar për punësimit të PMF-ve.
2. Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore punëson PMF me profil punonjës social;
3. Punonjësit e rinj firmosin kontratën, njihen me stafin dhe fillojnë me detyrat e tyre të përcaktuara në VKM nr. 578, *“Për procedurat e referimit të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”* dhe mbështetur në Ligjin Nr. 18/2017, *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit 3 – vjeçar të punësimit të PMF;
2. Miratimi në KB i planit 3 – vjeçar dhe përfshirja në buxhetin e vitit 2024, 2025 dhe 2026;
3. Punësimi i PMF sipas periudhës së përcaktuar në plan. Paga e një punonjësi social është 55 mijë lekë, bazuar në VKB nr. 133 *“Miratimi i numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2019”*.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Rritja e rasteve të identifikuar të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
2. Menaxhimi më efikas i rasteve të identifikuar.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore;
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i planit 3 – vjeçar	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore		0	0	0	0
2	Miratimi në KB i planit dhe përfshirja në buxhet	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore		0		0	0
3	Punësimi i PMF sipas periudhës së përcaktuar në plan (miratuar edhe planin social)	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore		0	0	8904000	
				0	0	8904000	
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore			

Nr. 016	Projekti: Promovimi i rolit dhe detyrave te PMF	Programi Buxhetor: 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët Funksioni: 10
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
Situata		
<p>Njohja e rolit dhe përgjegjësisë e PMF, shërbimet e tyre si dhe në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë në kopsht si pjesë e mekanizmit për mbrojtjen e fëmijëve është prioritare për të rritur mundësitë e një shërbimi cilësor në kopësht që garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në çdo kohë, jo vetëm gjatë raportimit, por përgjatë gjithë kohëqëndrimit në kopësht të fëmijës.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Me punësimin e PMF është e nevojshme njohja e stafit të NJA dhe bashkisë me rolin dhe detyrat e PMF, por gjithashtu, për të rritur mundësitë e një shërbimi cilësor në kopësht lind nevoja të promovohet roli i tij në komunitet, ne stafet akademike te kopshteve, etj.</p>		

ii Synimi i projektit

Siç u përmend edhe më lart, është e nevojshme që roli i PMF të promovohet në komunitet, nga stafet akademike te kopshteve dhe bordeve te prinderve.

Stafi i kopshteve duhet të njihet me PMF, të trajnohen mbi mënyrat e identifikimit të rasteve të fëmijëve të dhunuar, të dinë si të referojnë rastin dhe të kuptojnë rolin që ka PMF për mbrojtjen e fëmijëve. Është e nevojshme të ndërtohet një urë komunikimi dhe mirëbesimi mes stafit të kopshteve dhe PMF, në mënyrë që identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të jetë sa më efikas.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

PMF si koordinues të grupeve teknike ndërsektoriale nxisin përfaqësimin e kopshteve nga një person kontakti i zgjedhur sipas VKM 149. Lind nevoja e njohjes se bazës ligjore që ngarkon te gjitha institucionet në kontakt me fëmijën të jetë pjesë e GTN.

B: Menaxheriale

1. NJMF dhe PMF organizojnë sesione informuese me stafin e Institucioneve arsimore të kopshteve, mbi rolin e tyre dhe mënyrën e adresimit të çështjeve të fëmijëve tek PMF.
2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë sesione informuese me Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit.
3. PMF në NJA kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara nga VKM Nr. 578, datë 3.10.2018, *“Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”*.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Organizimi i takimeve informuese me stafin e kopshteve nga NJMF dhe PMF, me qëllim:
 1. Informimin mbi rolin e PMF,
 2. Diskutimin për çështje të mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe mënyrën e adresimit të çështjes pranë PMF.
2. Organizimi i takimeve informuese me Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit, Komisionin e Shëndetit

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Çdo institucion arsimor duhet të jetë i njohur me rolin dhe përgjegjësitë e PMF-së;

<p>2. Numri i telefonit të strukturave të Mbrojtjes së fëmijëve duhet të jetë i afishuar në ambientet e kopshteve;</p> <p>3. Çështje të mbrojtjes së fëmijëve diskutohen në mënyrë të vazhdueshme në bordin drejtues apo në këshillin e prindërve.</p>							
<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)</p> <p>Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit – NJMF dhe PMF në NJA</p>				<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p>			
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p>							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Takime informuese me drejtuesit e kopshteve	Njësia për mbrojtjen e fëmijëve		0	0	0	0
2	Takime informuese me Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit	Njësia për mbrojtjen e fëmijëve		0	0	0	0
				0	0	0	0
<p>f) Periudha e zbatimit: 2025</p>				<p>g) Ndjek zbatimin e projektit: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët</p>			

Nr. 017	Projekti: Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	Programi Buxhetor: 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët Funksioni: 10
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>i Situata</p> <p>Bashkia Dibër nuk e ka të ngritur Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR) pranë Njësive Administrative. NJVNR ka rol në identifikimin e nevojave për shërbime për të gjitha kategoritë në nevojë duke përfshirë grupin e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor që përballen me përjashtimin social si rrjedhojë e varfërisë, shëndetit, diskriminimit, strehimit të sigurt, etj. Për këtë arsye nuk ka të dhëna të numrit të fëmijëve gjithsej që janë të identifikuar në nevojë në moshë për kopsht të të gjitha profileve të nevojave.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Si rrjedhojë e mungesës së NJVNR në Njësitë Administrative janë hasur këto probleme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ka mungesë të informacionit për fëmijët në kushtet e përjashtimit social dhe me potencial për të përfituar shërbimet e kopshtit; • ka mungesë të vlerësimit të nevojave të grupeve në nevojë për hartimin e politikave, ngritjes së shërbimeve dhe adresimit të nevojave në nivel Bashkie; • ka mospërputhje të theksuar informacioni ndërmjet ZVAP, Bashkisë, Njësive Administrative dhe kopshteve mbi numrin e fëmijëve me nevojë për përfshirje sociale; • ka mungesë të paketave të lehtësimit për përfshirjen sociale si frekuentimi i kopshtit pa pagesë për fëmijët rom dhe egjiptiandhe për fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike. <p>Për të realizuar funksionet e përcaktuara, Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit, duhet të ketë të paktën:</p> <p>a) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6 000 deri në 10 000 banorë (Nenet 36 dhe 37 të Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”);</p> <p>b) një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3 000 fëmijë (Në përputhje me Ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”);</p> <p>c) administrator shoqëror (Detyra sipas ligjit për ndihmën ekonomike)</p> <p>Mungesa e punonjësve socialë në nivelin e njësive administrative ka bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve ligjore në këtë nivel, për rrjedhojë, zakonisht strukturat përgjegjëse të shërbimeve sociale në bashki angazhohen drejtpërdrejt edhe në menaxhimin e rasteve të ndryshme sociale. Kjo sjell jo vetëm ezaurim të panevojshëm të stafeve që në fakt nuk kanë detyrë funksionale menaxhimin e rasteve, por nuk është as në përputhje me interesin e vetë individëve në nevojë, të cilët duhet të përshkujnë distanca nga vendbanimi i tyre deri në bashki, duke shmangur kështu njësinë administrative.</p>		

ii Synimi i projektit

Synimi i këtij projekti është ngritja e NJVNR pranë çdo njësie administrative me 10 mijë banorë, npërmjet së cilës synohet të:

1. Identifikohen dhe vlerësohen fëmijët pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, etj);
2. Ngrihet një sistem i unifikuar për mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe analizimin e tyre për të gjithë fëmijët në nevojë për përfshirje sociale në moshë kopshti;
3. Hartohen politika dhe ofrohet paketa e shërbimeve për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe në moshë për kopsht;
4. Ofrohet asistenca për fëmijët e identifikuar me nevoja të ndryshme brenda ambjentit të kopshtit.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

Sipas Ligjit 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, është detyra e Bashkisë të ngrejë pranë Njësive Administrative Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe të caktojë nga një punonjës social për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë. Për këtë arsye është i nevojshëm:

1. Urdhër nga Kryetari i Bashkisë për ngritjen e NJVNR pranë njësive administrative.
2. Nxjerrja e një VKB për miratimin e pagave të punonjësve të strukturave të NJVNR pranë Njësive Administrative.

B: Menaxheriale

NJVNR, duhet të ketë të paktën:

1. një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6,000 deri në 10,000 banorë;
2. një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3,000 fëmijë;
3. administrator shoqëror.

Detyrat e NJVNR do të jenë:

1. Identifikimi i rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë
2. Vlerësimi fillestar i nevojave dhe riskun për individët në nevojë
3. Informimi dhe këshillimi publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla
4. Hartimi i planit individual të përkujdesit dhe mbështetjes

5. Bashkëndimi i mbështetjes për individët e familjet në nevojë, si dhe referimi te shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal e qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm
6. Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit
7. Mbikëqyrja në vazhdimësi e ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimi për përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar
8. Hedhja në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, sipas përcaktimit të Nenit 29, pika 2 të Ligjit 121/2016
9. Aplikimi për përfitim të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.
10. Plotësimi në Platformën Digjitale të dhënave për çdo fëmijë të identifikuar në nevojë

Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore pranë Bashkisë do të jenë përgjegjëse për mbikëqyrjen e shërbimeve sociale nga NJVNR në Njësitë Administrative. Është e këshillueshme që një prej punonjësve socialë të kësaj drejtorie të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe komunikimin me NJVNR.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Nxjerrja e një Urdhëri nga Kryetari i Bashkisë për ngritjen e NJVNR në 13 Njësitë Administrative të Bashkisë së Dibër. Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore rristrukojnë burimet njerëzore (punonjësit social, administratorët shoqërorë, PMF, etj.) për të krijuar organogramën e NJVNR dhe punësuar punonjësit e nevojshëm;
2. Paraqitja e strukturës së NJVNR të çdo Njësie Administrative në Këshillin Bashkiak për miratimin e ndryshimeve strukturore dhe buxhetit të pagave të punonjësve të rinj. Lobimi në Këshillin Bashkiak për rëndësinë e NJVNR në Njësitë Administrative dhe miratimin në buxhet të pagave të punonjësve që do të nevojiten shtesë;
3. Pas miratimit nga KB, fillon ngritja e strukturës së NJVNR në çdo Njësi Administrative të Bashkisë Dibër;
4. Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore është përgjegjëse për ngritjen e këtyre strukturave.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Ngritja e NJVNR në çdo NJA;
2. Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshiti me nevojë për përfshirje sociale;
3. Trajtimi në mënyrë efikase i çdo rasti të identifikuar.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtorja e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore
- Drejtorja e Burimeve Njerëzore
- Drejtorja e Arsimit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Nxjerrja e Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për ngritjen e NJVNR	Kryetari i Bashkisë		0	0	0	0
2	Krijimi i organogramës së NJVNR për çdo NJA	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shendetësore		0	0	0	0
3	Paraqitja në KB	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shendetësore		0	0	0	0
4	Ngritja e strukturës – rekrutimi i stafit	Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shendetësore/ Drejtoria e Burimeve Njerëzore		0	0	1272000	
				0	0	1272000	0
f) Periudha e zbatimit: 2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shendetësore			

3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar

3.5.1 Adresimi i prindërve

Informacion i përgjithshëm

Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor është evidentuar se mësuesit e kopshteve hasin probleme me prindërit në momentin që ata dyshojnë se fëmija mund të jetë me aftësi të kufizuar. Prindërit nuk pranojnë të vizitojnë fëmijën e tyre sepse refuzojnë të pranojnë se mund të jetë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike.

Qendresa që bëjnë prindërit kur dyshohet se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuar vonon procesin e diagnostikimit të fëmijëve dhe trajtimin e tyre sa më parë. Për këtë arsye duhet ndërhyrë nga Drejtoria e Arsimit dhe Shërbimi Psiko-Social për të punuar me këtë problem.

Objektiva kryesore:

Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Përmirësimi i komunikimit mësues-prind gjatë procesit të diagnostikimit të fëmijës nëpërmjet trajnimit të stafit të kopshteve dhe ofrimit të shërbimit psiko-social për prindërit

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikator	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
047	Numri i fëmijëve me AK të diagnostikuar këtë vit	Qender	Vlere	Shumatore	6	7	7	8
047	Numri i fëmijëve me AK të	Periferi	Vlere	Shumatore	3	4	4	4

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	diagnostikuar këtë vit							
047	Numri i fëmijëve me AK të diagnostikuar këtë vit	Fshat	Vlere	Shumatore	8	9	9	10
048	Fëmijë me AK që janë diagnostikuar pas dyshimit të stafit të kopshtit (%)	Qender	%	Tjeter	3	3	5	7
048	Fëmijë me AK që janë diagnostikuar pas dyshimit të stafit të kopshtit (%)	Periferi	%	Tjeter	3	3	4	5
048	Fëmijë me AK që janë diagnostikuar pas dyshimit të stafit të kopshtit (%)	Fshat	%	Tjeter	8	8	8	9
049	Numri i fëmijëve me AK në total	Qender	Vlere	Shumatore	7	7	7	8
049	Numri i fëmijëve me AK në total	Periferi	Vlere	Shumatore	4	4	4	4

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
049	Numri i fëmijëve me AK në total	Fshat	Vlere	Shumatore	9	9	9	10

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
016	Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve	Drejtoria e Arsimit		86000	0	0	0

Listae projekteve

Nr. 016	Projekti: Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve	Programi Buxhetor: 10140 - Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara Funksioni: 10
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor është evidentuar se mësuesit e kopshteve hasin probleme me prindërit në momentin që ata dyshojnë se fëmija mund të jetë me aftësi të kufizuar. Prindërit nuk pranojnë të vizitojnë fëmijën e tyre sepse refuzojnë të pranojnë se mund të jetë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		

Qendresa që bëjnë prindërit kur dyshohet se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuar vonon procesin e diagnostikimit të fëmijëve dhe trajtimin e tyre sa më parë. Për këtë arsye duhet ndërhyrë nga Njësia e Arsimit Parashkollor dhe Shërbimi Psiko-Social për të punuar me këtë problem.

ii Synimi i projektit

Ky projekt synon rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimin e specializuar të fëmijës me aftësi të kufizuar dhe asistimin e mësuesve gjatë procesit të komunikimit me prindërit.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Miratimi i buxhetit në për trajnimet e mësuesve në KB

B: Menaxheriale

1. Hartimi i planit të trainimit të mësuesve të arsimit parashkollor mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind nga psikologët e Drejtorisë së Arsimit. Trainimet mund të organizohen në nivel Njësie Administrative për mësuesit që punojnë në kopshtet që ndodhen në zonat rurale dhe në nivel rajoni për mësuesit e kopshteve që ndodhen në qytetin e Dibërs. Në këtë mënyrë do të organizohen 13 trajnime.
2. Trajnimet e organizuara në qytet nuk kanë kosto, ndërsa ato të organizuara në Njësitë Administrative kanë kostot e transportit;
3. Organizim i trajnimeve për mësuesit e arsimit parashkollor nga psikologët e Drejtorisë së Arsimit mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind;
4. Mësuesi njofton Sektorin për Arsimin në rast se has një problem me prindërit përsa i përket diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar;
5. Drejtoria e Arsimit vë në dispozicion një psikolog për të trajtuar problematikën e raportuar, duke komunikuar me prindërit dhe mësuesin.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit të trajnimeve për mësuesit;
2. Miratimi i planit të trajnimeve në KB;
3. Organizim i trajnimeve për mësuesit mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind.
4. Ofrimi i shërbimit psiko-social për prindërit që kanë vështirësi për të pranuar se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuara.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Përsheptim i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Arsimit; • Njësia e Arsimit Parashkollor 	Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.) <ul style="list-style-type: none"> • OJF
---	---

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i planit të trajnimeve për mësuesit	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
2	Miratimi i planit të trajnimeve në KB	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
3	Organizim i trajnimeve për mësuesit mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind	Drejtoria e Arsimit		86000	0	0	0
4	Ofrimi i shërbimit psiko-social për prindërit	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
				86000	0	0	0

f) Periudha e zbatimit:

2024

g) Ndjek zbatimin e projektit:

Drejtoria e Arsimit/Njësia e Arsimit Parashkollor

3.5.2 Kërkesa për fonde shtesë

Informacion i përgjithshëm

Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar të regjistruar në kopsht është 21. Infrastruktura e kopshteve nuk është e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në disa kopshte mungojnë rampat, të cilat janë shumë të nevojshme për tu vendosur, në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve, gjithashtu mungojnë edhe tualetet për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Objektiva kryesore:

Plotësimi i standardeve të aksesueshmërisë të fëmijëve me AK në arsimin parashkollor

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Heqja e barrierave që pengojnë aksesueshmërinë e fëmijëve me AK në kopshte

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
055	Kopshte që kanë rampa (%)	Qender	%	Tjeter	2	0	0	0
055	Kopshte që kanë rampa (%)	Periferi	%	Tjeter	10	10	5	5
055	Kopshte që kanë rampa (%)	Fshat	%	Tjeter	23	15	5	11

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periudhe
017	Vendosja e rampave dherespektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore	Drejtoria e Arsimit		0	100000	40000	64000

Listae projekteve

Nr. 017	Projekti: Vendosja e rampave dherespektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Në Bashkinë Dibër numri i fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të regjistruar në kopsht është 21 fëmijë. Nga 86 kopshte në total vetëm 35 kopshte janë të pajisur me Rampa. Kopshtet që kanë rampë janë në përgjithësi ato kopshte të cilat ndodhen brenda shkollave të rikonstruara vitet e fundit.</p> <p>Në përgjithësi disa kopshte janë përdhës (pa shkallë në hyrje) dhe nuk kanë nevojë për rampa (fëmijët me AK akomodohen në katet e para).</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Eshtë e nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, dhe të ndërtohen tualete për fëmijë me AK në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve.		
ii Synimi i projektit		
Synimi i këtij projekti është pajisja e gjithë ndërtesave të kopshteve me rampa për të lehtësuar aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuar në kopsht. Në Bashkinë Dibër janë gjithsej 51 kopshte publike për t'u pajisur me rampa.		

Në VKM nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, përcaktohen masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. gjetja e donatorit për projekte konkrete për vendosjen e rampave dhe tualeteve në kopshte;
2. Firmosja e kontratës mes Bashkisë dhe donatorit.

B: Menaxheriale

1. Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave dhe tualeteve në kopshte nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtoria e Arsimit. Plani do të përmbajë shtrirjen kohore të ndërhyrjes, kopshtet që do të vendosen rampa çdo vit dhe kostot;

C: Infrastrukturore

1. Vendosja e rampave në kopshte nga donatori.
2. Ndërtimi i tualeteve.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave dhe ndërtimin e tualeteve në kopshte nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit;
2. Miratimi në KB i buxhetit për vendosjen e rampave dhe tualeteve në kopshte;
3. zbatimi i marreveshjes me donatorin.
4. Vendosja e rampave në kopshte nga donatori.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Të gjithë kopshtet kanë rampa dhe tualete në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të aksesojnë lehtësisht kopshtin.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit,

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF
- Operator/ët ekonomik

<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. 							
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)							
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i planit	Drejtoria e Arsimit	0	0	0	0	0
2	Miratimi në KB i buxhetit	Drejtoria e Arsimit	0	0	0	0	0
3	Nisja e punes per gjetjen e donacioneve, apo fondeve qeveritare per vendosjen e rampave dhe tualeteve ne kopeshte	Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimet Mbështetëse	0	0	0	0	0
4	Vendosja e rampave dhe tualeteve në kopshte nga donatori	Operatori/ët ekonomik	0	0	100000	40000	640000
					100000	40000	640000
f) Periudha e zbatimit: 2025				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit			

Risqet

Risku	Mitigimi
Mungesa e fondeve për të financuar këtë projekt rrezikon realizimin e tij	Përpjekja për të gjetur donatorë

3.5.3 Ndhimja e përditshme

Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet publike të Bashkisë së Dibër janë regjistruar 20 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe në këtë bashki nuk kë mësuese ndihmëse, por janë vendur 2 punonjës nga bashkia për të ofruar asistencë ndaj këtyre fëmijëve ne kopshtet e qytetit. Kompetenca për punësimin e mësuesve ndihmës i ka kaluar bashkisë.

Objektiva kryesore:

Përmirësimi i procesit të trajtimit të fëmijëve me AK.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Ndjekja e ecurisë së fëmijës me AK që nga momenti i diagnostikimit dhe plotësimi i nevojave të tij

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikator	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
051	Kopshtet ku janë regjistruar fëmijë me AK	Qender	Vlere	Shumatore	7	7	7	8
051	Kopshtet ku janë regjistruar fëmijë me AK	Periferi	Vlere	Shumatore	4	4	4	5
051	Kopshtet ku janë regjistruar fëmijë me AK	Fshat	Vlere	Shumatore	9	9	9	10
052	PEI të hartuara për fëmijët me AK ndaj numrit të fëmijëve me AK (%)	Qender	%	Tjeter	7	7	7	8
052	PEI të hartuara për fëmijët me AK ndaj	Periferi	%	Tjeter	0	0	2	4

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	numrit të fëmijëve me AK (%)							
052	PEI të hartuara për fëmijët me AK ndaj numrit të fëmijëve me AK (%)	Fshat	%	Tjeter	0	2	4	9
053	Numri i fëmijëve me AK të regjistruar në kopsht	Qender	Vlere	Shumatore	7	7	7	8
053	Numri i fëmijëve me AK të regjistruar në kopsht	Periferi	Vlere	Shumatore	4	4	4	5
053	Numri i fëmijëve me AK të regjistruar në kopsht	Fshat	Vlere	Shumatore	9	9	9	10
054	Fëmijë të diagnostikuar me AK që kanë lënë kopshtin	Qender	Vlere	Shumatore	0	0	0	0
054	Fëmijë të diagnostikuar me AK që kanë lënë kopshtin	Periferi	Vlere	Shumatore	0	0	0	0
054	Fëmijë të diagnostikuar me AK që kanë lënë kopshtin	Fshat	Vlere	Shumatore	0	0	0	0

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
018	Punësimi i mësueseve ndihmëse	Drejtoria e Arsimit		96960000	96960000	96960000	290880000

Listae projekteve

Nr. 018	Projekti: Punësimi i një mësuese ndihmëse	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Në Bashkinë Dibër ka 20 fëmijë të regjistruar me AK nga të cilët 11 janë vajza, ndërkohë që nuk ka asnjë mësuese ndihmëse të punësuar në kopshte.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Kompetenca e menaxhimit të kopshteve dhe punësimit të mësuesve ndihmës i ka kaluar pushtetit vendor, megjithatë Bashkisë Dibër në transfertat e kushtëzuara për paga dhe kontribute nuk i vjen asnjë fond për mësues ndihmës.</p> <p>Ndërkohë, në Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 2: ZVA përcakton mësues ndihmës për fëmijët me AK bazuar në diagnozën e Komisionit Multidisiplinor.</p>		
ii Synimi i projektit		
<p>Ky projekt ka si synim zgjidhjen e situates se mesuesve ndihmes ne Bashkine Diber nepermjet 2 menyrave. E para eshte arritja e nje marreveshje me Ministrine e Financave, pasi fondi per mesuesit ndihmes mund te kerkohet qe te shtohet ne transferte specifike per arsimin parashkollor, dhe masa e fondit caktohet nepermjet nje kerkese rreth muajit shtator tetor ku Drejtoria e arsimit ne bashki ka nje numer fiks te femijeve me AK te regjistruar ne vitin shkollor. Ky plan sherben per llogaritjen e transfertes per vitin pasardhes per shtesen e mesuesve ndihmes per AK.</p> <p>E dyta eshte hartimi e nje marreveshjeje bashkepunimi mes ZVAP dhe Bashkisë në lidhje me menaxhimin e rasteve të fëmijëve me AK, duke qenë se ZVAP merr pjesë në procesin e diagnostikimit dhe trajtimit të fëmijëve me AK. Në marrëveshje do të përcaktohen qartë kompetencat, të drejtat dhe detyrat e Bashkisë dhe ZVAP në lidhje diagnostikimin dhe trajtimin e fëmijëve me AK.</p>		

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

Takimi mes ZVAP dhe Bashkisë dhe hartimi i një marrëveshjeje që përcakton kompetencat e secilit bazuar në aktet ligjore në lidhje me trajtimin e rasteve të fëmijëve me AK si dhe dakordesi mes Bashkisë dhe Ministrisë së Financave për përcaktimin e afateve dhe praktikës për tu ndjekur vit pas viti.

B: Menaxheriale

1. Punësimi i mësuesve ndihmës në rastet kur nga 2023 fëmijët në moshë për kopsht arrijnë të regjistrohen fëmijë në kopsht do të duhen më tepër mësues mbështetës. Nëse i përmbahemi Urdhrit nr. 31, nenit 81, atëherë kostot për punësimin e mësuesve ndihmës do të financohet nga ZVAP.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Takimi mes ZVAP dhe Bashkisë dhe hartimi i një marrëveshjeje që përcakton kompetencat e secilit bazuar në aktet ligjore në lidhje me trajtimin e rasteve të fëmijëve me AK.
2. Dakordesi mes Bashkisë dhe Ministrisë së Financës mbi kerkesat, procedure, afatet dhe menyren e llogaritjes mbi bazën e udhëzimeve për punësimin e mësuesve ndihmës.

2. Punësimi i një mësuesi ndihmës. *Paga e një mësuesi ndihmës është supozuar = 50.5 mijë lekëx12muajx nr e mesuesve ndihmes. Nr e mesuesve qe nevojiten llogaritet bazuar ne udhezimin Nr 26 qe cakton 2-3 femije per mesues ndihmes.*

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme).

1. Procedurat e diagnostikimit dhe trajtimit të fëmijëve me AK janë të qarta për Bashkinë dhe ZVAP.

2. Punësimi i një mësuesi ndihmës

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Kryetari i Bashkisë
- Sektori për Arsimin

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- ZVAP, Ministria e Financës

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 204	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Takimi mes	Kryetari i Bashkisë/Drejtorja e Arsimit/ZVAP		0	0	0	0

	ZVAP dhe Bashkisë						
2	Punësimi i një mësuesi ndihmës	Sektori për Arsimin/Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse		0	96960000	96960000	
				0	96960000	96960000	
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Punësimi i një mësuese ndihmëse			

4. Proceset Mbështetëse- Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

4.1 Qëllimi

Proceset mbështetëse janë procese që ofrojnë mbështetje për proceset kryesore. Proceset mbështetëse duhet të gjenden brenda ose jashtë institucionit. Në shembullin e kopshtit, një proces mbështetës mund të jetë shtimi i burimeve njerëzore pranë Bashkisë, për të koordinuar në aktivitetet e planit të përmirësimit të arsimit parashkollor.

Planet e përmirësimit të shërbimit kanë si qëllim ofrimin e shërbimit sa më efikas të kopshteve në aspektin e edukimit të fëmijëve, sigurisë së tyre, zhvillimit të tyre dhe sigurimin e aksesueshmërisë së shërbimit nga të gjithë. Plani fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës së godinave të kopshteve, formimin dhe ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të arsimit parashkollor si dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve në të gjitha strukturat e arsimit parashkollor në të gjithë territorin që mbulon Bashkia Dibër.

4.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përsa i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike, cilësinë e ushqimit dhe sigurimin e aksesit në kopsht.

4.3 Burimet Njerëzore

4.3.1 Rekrutimi i stafit

Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet e Bashkisë Dibër ofrojnë shërbimin 109 mësues në total prej të cilëve 54 ofrojnë shërbim në kopshtet e qytetit dhe 55 mësues ofrojnë shërbim në kopshtet e njësive administrative.

Nëse do të analizojmë numrin e mësueseve për fëmijë, numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike është 1831 fëmijë, numri i mësueseve është 109 dhe numri i fëmijëve për mësuese është mesatarisht 16.7 fëmijë për një mësuese. Raporti fëmijë – mësuese është e parashikuar nga udhëzimi nr. 14.

Njësia Administrative **Numri mesatar i fëmijëve për 1 mësuese**

<i>Fushë-Çidhen</i>	18
<i>Kala e Dodës</i>	13
<i>Kastriot</i>	18
<i>Luzni</i>	22
<i>Maqellarë</i>	31
<i>Melan</i>	12
<i>Peshkopi</i>	11
<i>Slovë</i>	22
<i>Tomin</i>	15
<i>Zall Dardhë</i>	5
TOTALI	16

Nga 86 kopshte publike të marra në analizë, vetëm 26 prej tyre janë në godinë më vete. Pjesa tjetër e kopshteve publike janë akomoduar brenda godinave të shkollave. Këto kopshte menaxhohen gjithashtu nga drejtuesi i shkollës së arsimit bazë apo nga një mësues përgjegjës.

Objektiva kryesore:

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të kopshteve duke siguruar nivelin e duhur të stafit përcaktuar nga aktet ligjore.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Aplikimi i Udhëzimit Nr.14, sipas të cilit kemi një drejtor për 5 grupe nxënësish në kopsht

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
080	Raporti i qendrueshmërisë së mësuesve	Qender	%	Mesatare	60	70	80	90
080	Raporti i qendrueshmërisë së mësuesve	Periferi	%	Mesatare	60	70	80	90
080	Raporti i qendrueshmërisë së mësuesve	Fshat	%	Mesatare	60	70	80	90
078	Numri i fëmijëve për një mësuese	Qender	Vlere	Mesatare	11	11	11	11
078	Numri i fëmijëve për një mësuese	Periferi	Vlere	Mesatare	12	12	12	12
078	Numri i fëmijëve për një mësuese	Fshat	Vlere	Mesatare	16	16	16	16
057	Kopshte që menaxhohen nga drejtues të shkollave	Qender	Vlere	Shumatore	0	0	0	0
057	Kopshte që menaxhohen nga drejtues të shkollave	Periferi	Vlere	Shumatore	10	10	5	0
057	Kopshte që menaxhohen nga drejtues të shkollave	Fshat	Vlere	Shumatore	40	35	25	20
056	Numri i drejtuesve të kopshteve	Qender	Vlere	Shumatore	2	3	3	3

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
056	Numri i drejtuesve të kopshteve	Periferi	Vlere	Shumatore	1	1	2	3
056	Numri i drejtuesve të kopshteve	Fshat	Vlere	Shumatore	1	1	2	3

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
019	Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet për 5 grupe fëmijësh	Drejtorja e Arsimit	0	0	3330000	3330000	6660000

Listae projekteve

Nr. 019	Projekti: Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet për 5 grupe fëmijësh	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Nga 86 kopshte publike të marra në analizë, vetëm 26 prej tyre janë në godinë më vete. Pjesa tjetër e kopshteve publike, janë akomoduar brenda godinave të shkollave. Këto kopshte menaxhohen gjithashtu nga drejtuesi i shkollës së arsimit bazë ose nga një mësues përgjegjës.</p> <p>Bashkia në bazë të buxhetit do të llogarisë sa drejtorë të rinjë do të shtoj në strukturën e saj. Edukatorët do të raportojnë për çdo problematik tek këta persona.</p>		

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Drejtuesit e kopshteve kanë shumë detyrë të rëndësishme në menaxhimin e kopshtit dhe është e pamundur që një mësuese t'i kryejë ato, sidomos duke marrë parasysh faktin se mësuesja ka përgjegjësi të tjera.

Gjithashtu, kopshtet që janë brenda godinave të shkollave dhe që menaxhohen nga drejtuesit e tyre nuk janë tërësisht nën menaxhimin e bashkisë, pasi vetë drejtuesi i tyre raporton drejtpërsëdrejti te ZVAP.

Për këtë arsye, është e nevojshme që kopshtet të kenë drejtuesit e tyre dhe jo drejtuesit e shkollave ose mësues përgjegjës. Në këtë rast do të ndihmojë në përmirësimin e shërbimit zbatimi i Udhëzimit Nr. 14, ku tëvendoset 1 drejtues kopshti për 4 grupe (grupe me ushqim) dhe për 5 grupe (për grupe pa ushqim). Per rastin e Bashkise Diber eshte menduar nje numer 5.

ii Synimi i projektit

Duke vendosur një drejtues për 5 grupe fëmijësh në kopshte, i cili raporton në Sektorin e Arsimit dhe ka si detyrë të vetme menaxhimin e kopshteve, synohet:

1. Menaxhimi më efikas i kopshteve;
2. Nevojat dhe problemet e kopshteve adresohen në kohën e duhur dhe institucionin e duhur, duke marrë zgjidhje më shpejt;
3. Lehtësimi i procesit të edukimit, sepse mësueset do të fokusohen vetëm në edukimin dhe menaxhimin e klasës së tyre.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Arritje e dakordësive me nivelin qendror për ri llogaritjen e transfertes specifike, sipas udhëzimeve të Ministrisë për shtimin e 5 drejtoreve të Kopshteve.
2. Miratimi i buxhetit për punësimin e drejtuesve të kopshteve sipas Udhëzimit nr. 14;
3. Nxjerrja e një Urdhëri nga Kryetari i Bashkisë për zbatimin e Udhëzimit nr. 30/2023 dhe udhëzime specifike në rastin kur për shkak të infrastrukturës apo transportit nuk mund të realizohet udhëzimi 1 drejtues për 5 grupe.

B: Menaxheriale

1. Drejtoria e Arsimit harton planin për punësimin e drejtuesve të rinj: sa drejtues duhen dhe cilët kopshte do të menaxhojnë;
2. Drejtoria e Arsimit i paraqet KB planin dhe buxhetin për miratim;

3. Pas miratimit të planit dhe buxhetit nga KB dhe nxjerrjes së Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për punësimin e Drejtuesve fillon procedura e punësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit dhe buxhetit të punësimit të drejtuesve (sa drejtues, për cilat kopshte dhe kur do punësohen);
2. Propozimi dhe miratimi në KB;
3. Punësimi i drejtuesve të rinj në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Paga e 1 drejtuesi kopshti pa ushqim është 55,500lekë.
4. Ri-organizimi i përgjegjësive dhe kopshteve nën menaxhim të drejtuesve të kopshteve

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Menaxhimi efikas i kopshteve;
2. Zgjidhja më e shpejtë e problemeve që mund të ketë çdo kopsht;
3. Procesi i nxënies së fëmijëve më efikas.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Hartimi i planit dhe buxhetit të punësimit të drejtuesve	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
2	Propozimi dhe miratimi në KB	Drejtoria e Arsimit	0	0	0	0	0

3	Punësimi I 5 drejtuesve të rinj	Drejtoria e Arsimit/Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	1998000	666000	3330000	3330000	
4	Ri-organizimi i përgjegjësive dhe kopshteve nën menaxhim të drejtuesve të kopshteve	Drejtoria e Arsimit	0	0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2025- 2026			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit				

4.3.2 Trajnimi i stafit

Informacion i përgjithshëm

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) ka si përgjegjësi rritjen e kapaciteteve të stafit të IA nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme. Për mësuesit e arsimit parashkollor janë 3 trajnime vjetore të detyruara.

Gjithashtu, kopshtet e Bashkisë Dibër stafi nuk është i përgatitur për mënyrën e reagimit në rastin e situatave emergjente, përfshirë këtu edhe kur mund të jetë e nevojshme dhënia e ndihmës së parë. Për këto arsye është e nevojshme rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve.

Objektiva kryesore:

Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Kryerja e tranimeve vjetore akredituese të stafit të kopshteve nga ASCAP

Nr	Pershkrimi
2	Trainimi i stafit të kopshteve për rastet e emergjencave, ndihmën e parë, përdorimin e internetit, microsoft office, etj.

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
060	Numri i mësuesve të trajnuar nga OJF të ndryshme	Qender	Vlere	Mesatare	0	10	20	30
060	Numri i mësuesve të trajnuar nga OJF të ndryshme	Periferi	Vlere	Mesatare	0	15	25	30
060	Numri i mësuesve të trajnuar nga OJF të ndryshme	Fshat	Vlere	Mesatare	0	10	20	30
059	Numri i mësuesve të trajnuar nga universitete të ndryshëm	Qender	Vlere	Mesatare	0	0	0	0
059	Numri i mësuesve të trajnuar nga	Periferi	Vlere	Mesatare	0	0	0	0

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
	universitete të ndryshëm							
059	Numri i mësuesve të trajnuar nga universitete të ndryshëm	Fshat	Vlere	Mesatare	0	0	0	0
058	Numri i mësuesve të trajnuar pranë ASCAP	Qender	Vlere	Mesatare	20	30	35	40
058	Numri i mësuesve të trajnuar pranë ASCAP	Periferi	Vlere	Mesatare	20	30	35	30
058	Numri i mësuesve të trajnuar pranë ASCAP	Fshat	Vlere	Mesatare	25	30	30	35

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
022	Marrëveshje bashkëpunimi ndër-institucionale	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0
021	Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve	Drejtoria e Arsimit		0	86000	0	86000

Numri	Projekti	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026	Total periodhe
020	Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me ASCAP	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0

Listae projekteve

Nr. 020	Projekti: Hartimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me ASCAP	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) ka si përgjegjësi rritjen e kapaciteteve të stafit të IA nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme. Për mësuesit e arsimit parashkollor janë 3 trainime vjetore të detyruara.</p> <p>ASCAP ka hartuar Metodën e Vlerësimit të Brendshëm të Shkollave. Vlerësimi i Brendshëm është i një praktikë e cila nxit vet-përmirësimin duke njohur pikat e forta dhe më pak të forta në nivel institucioni. Për vlerësimin e brendshëm të kopshteve nuk ka një metodë zyrtare të publikuar nga ASCAP.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Eshtë e nevojshme të hartohet një marrëveshje bashkëpunimi mes Bashkisë dhe ASCAP në mënyrë që mësuesit të zhvillojnë trajnimet e nevojshme dhe të marrin njohuritë e duhura.		
ii Synimi i projektit		
Nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit Drejtoria e Arsimit do të pajiset çdo vit me kalendarin e trajnimeve dhe do ta dërgojë atë në çdo IA, në mënyrë që gjithë stafi të jetë në dijeni për kohën dhe vendndodhjen e trajnimeve. Në këtë mënyrë, trajnimet nuk do kryhen më kundrejt pagesës, por do të kryhen nga ASCAP, kështu do të ketë më shumë siguri edhe për kryerjen e tyre siç duhet dhe jo formalisht.		

Gjithashtu, gjatë takimit me ASCAP do të shihet mundësia e hartimit të Metodës së Vlerësimit të Brendshëm të Kopshteve nga ASCAP, në mënyrë që kopshtet të bazohen tek ajo për procesin e vlerësimit të brendshëm.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Bashkisë & ASCAP.

B: Menaxheriale

1. Organizimi i një takimi mes përfaqësuesve të Drejtorisë së Arsimit, ZVAP dhe ASCAP për të diskutuar mbi procedurat e trajnimeve që kryhen dhe metodën e Vlerësimit të Brendshëm të Kopshteve;
2. Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi për të siguruar zgjidhjen e problematikave ekzistuese;
3. Drejtoria e Arsimit merr nga ASCAP kalendarin e trajnimeve (jo vetëm të detyrueshmet), broshura të hartuara nga ASCAP dhe ua dërgon kopshteve ose institucioneve përgjegjëse.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Organizimi i takimit mes përfaqësuesve të Drejtorisë së Arsimit dhe ASCAP;
2. Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Kryerja e trajnimeve akredituese të stafit të IA;
2. Rritja e kapaciteteve të stafit të IA;
3. Përmirësimi i procesit të Vlerësimit të Brendshëm të kopshteve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Arsimit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- ASCAP

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Organizimi i takimit mes përfaqësuesve të Drejtorisë së Arsimit dhe ASCAP	Drejtorja e Arsimit		0	0	0	0
2	Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit	Drejtorja e Arsimit		0	0	0	0
				0	0	0	0
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtorja e Arsimit			

Nr. 021	Projekti: Rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Kopshtet e Bashkisë Dibër stafi nuk është i përgatitur për mënyrën e reagimit në rastin e situatave emergjente, përfshirë këtu edhe kur mund të jetë e nevojshme dhënia e ndihmës së parë.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Një nga nevojat e Bashkisë Dibër është rritja e kapaciteteve të stafit të kopshteve. Është e nevojshme që të kryhen trajnime nga Bashkia Dibër për stafin e IA për temat:		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndihma e parë; 2. Reagimi në situata rreziku të godinave; 		
ii Synimi i projektit		

Ky projekt synon rritjen e kapacitetit të stafit të kopshteve përsa i përket ndihmës së parë dhe reagimit në situata emergjente.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Bashkia i kërkon Shërbimit Zjarrfikës kryerjen e trajnimeve të stafit të kopshteve për reagimin në situata zjarri, tërmeti, përmbajtje, etj;
2. Bashkia kontakton me Kryqin e Kuq dega Dibër dhe i kërkon kryerjen e trajnimeve për Ndhmën e Parë për stafin e kopshteve;
3. Organizimi i kalendarit të trajnimeve nga Drejtoria e Arsimit.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq dega Dibër dhe Shërbimin Zjarrfikës së Dibres për kryerjen e trajnimeve të stafit të kopshteve;
2. Kryerja e trajnimeve për qytetin e Peshkopisë dhe për çdo NJA. Kostot për një person janë 1000 lekë të reja. Do të shihet mundësia që këto trajnime të jenë në të njëjtën ditë, për të minimizuar kostot.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Rritje e kapacitetit të stafit të IA;
2. Shmangia e situatave të rrezikut dhe mbrojtja fizike e fëmijëve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Arsimit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Shërbimi Zjarrfikës
- Kryqi i Kuq

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Fakt Aktual	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026	Total
1	Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq dega Dibër dhe Shërbimin Zjarrfikës së Dibër	Drejtoria e Arsimit		0	0	0	0

2	Kryerja e trajnimeve për qytetin e Dibër dhe për çdo NJA	Drejtoria e Arsimit		0	86000	0	86000
				0	86000 lekë	0	86000 lekë
f) Periudha e zbatimit: 2025				g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Arsimit			

Nr. 022	Projekti: Marrëveshje bashkëpunimi institucionale ndër-	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
		Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
